**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština-Assembly

# Doracak

## FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KOMISIONEVE PARLAMENTARE



Prishtinë, Qershor 2012

**Republika e Kosovës**
Repubika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština-Assembly

# Doracak

## FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KOMISIONEVE PARLAMENTARE



Prishtinë, Qershor 2012

**Botimi i parë**

**Anëtarët e grupit punues:**

Xheladin Hoxha
*Udhëheqës i Divizionit për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare*

Fatime Qorri
*Koordinatore e Komisionit*

Armend Ademaj
*Koordinator i Komisionit*

Shaip Goxhuli
*Zyrtar i Komisionit*

Agron Demi
*Bashkëpunëtor i jashtëm i NDI*

Rinor Beka
*Menaxher i Programit Legjislativ të NDI*

Shefki Kastrati
*Zyrtar i  Programit Legjislativ të NDI*

*Publikimi i këtij doracaku është  mundësuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI).*

NDI
NATIONAL DEMOCRATIC INSTITUTE FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

## PËRMBAJTJA

1.HYRJE.....5

2. FUNKSIONI MBIKËQYRËS I PARLAMENTIT.....7
*2.1. Roli i komisioneve .....8*
*2.2. Baza ligjore për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës.....8*

3. PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE MBIKËQYRËSE.....12
*3.1. Plani vjetor i punës.....12*
*3.2. Përcaktimi i aktiviteteve mbikëqyrëse.....13*
*3.3. Formimi i grupeve punuese për aktivitetet mbikëqyrëse.....13*
*3.4. Hartimi i planit të veprimit për mbikëqyrje.....14*

4. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT.....16
*4.1. Hulumtimet dhe analizat për çështjen nën mbikëqyrje.....16*
*4.2. Vizitat e grupit punues në terren.....16*
*4.3. Seancat dëgjimore mbikëqyrëse.....17*
*4.4. Angazhimi i organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të pavarur.....18*
*4.5. Transparenca e procesit dhe promovimi i aktiviteteve mbikëqyrëse.....18*

5. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LIGJEVE.....20
*5.1. Raporti i rregullt vjetor i ministrisë për zbatimin e ligjeve.....20*
*5.2. Detyrimet e komisionit para Kuvendit.....21*
*5.3. Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.....21*
*a) Identifikimi i obligimeve që parasheh ligji për qeverinë, institucionet publike dhe private.....24*
*b) Vlerësimi i përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin.....24*
*c) Organizimi i vizitave mbikëqyrëse në terren.....25*
*d) Raportimi i ministrit apo zyrtarit përgjegjës në Komision.....26*
*e) Organizimi i dëgjimit mbikëqyrës.....27*
*h) Përgatitja e raportit me rekomandime.....28*
*i) Shqyrtimi i raportit me rekomandime në Komision.....28*
*j) Shqyrtimi i raportit me rekomandime në seancë plenare.....29*
*k) Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve.....29*

6. MBIKËQYRJA E BUXHETIT.....31
*6.1. Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës.....31*
*6.2. Raportimi i organizatave buxhetore në Kuvend.....33*
*6.3. Mbikëqyrja e zbatimit të buxhetit nga komisionet parlamentare.....35*
*6.4. Mbikëqyrja e zbatimit të strategjive të Qeverisë.....37*
*6.5. Roli i Kuvendit në adresimin e sfidave të Raportit të Progresit për Kosovën.....38*

7. MBIKËQYRJA E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA.....40
*7.1. Përgjegjësia e Kuvendit në raport me institucionet e pavarura.....41*
*7.2. Miratimi i buxhetit të institucioneve të pavarura.....41*
*7.3. Emërimi i udhëheqësve të institucioneve dhe anëtarëve të bordeve.....42*
*7.4. Përgjegjësitë e institucioneve të pavarura ndaj Kuvendit.....43*

4. SHTOJCAT........................................................................................................................45
1. Forma standarde e planit të veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve....47
2. Forma standarde për identifikimin e obligimeve që parasheh Ligji për zbatuesit .51
3. Forma standarde për vlerësimin e përputhshmërisë së akteve nënligjore........52
4. Forma standarde e pyetjeve esenciale gjatë vizitave mbikëqyrëse....................53
5. Forma standarde e raportit final...................................................................54
6. Lista e të gjitha institucioneve të pavarura...............................................57
7. Afatet kohore, detyrimet e Qeverisë dhe Kuvendit në procesin buxhetor.......69
8. Strategjitë dhe planet e veprimit të miratuara ndër vite, zbatueshmëria e të cilave përfshinë vitin 2012 dhe vitet në vazhdim...................................................71

# Hyrje

Doracaku "Funksioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare" është publikimi i radhës që Kuvendi i Kosovës nxjerr me qëllim të lehtësimit të punës së anëtarëve të komisioneve dhe stafit mbështetës gjatë ushtrimit të aktiviteteve mbikëqyrëse. Ky doracak bazohet në dokumentet ligjore të cilat rregullojnë fushën e mbikëqyrjes parlamentare, siç janë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Rregullorja e Kuvendit të Kosovës dhe Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve. Ky doracak, do të lehtësojë zbatimin praktik të normave të mbikëqyrjes të cilat parashihen me aktet ligjore dhe praktikat më të mira parlamentare.

Përmes këtij doracaku synohet unifikimi i praktikave më të mira të vendosura dhe të zbatuara nga komisionet e Kuvendit gjatë këtyre viteve të funksionimit të tij. Doracaku bazohet në nenin 65 pika 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas së cilit Kuvendi i Kosovës mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit. Po ashtu, ky doracak bën interpretimin praktik të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, i cili bën fjalë për mbikëqyrjen parlamentare nga ana e komisioneve.

Përderisa Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit parashohin të drejtën e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e komisioneve, në praktikë ekzistojnë mënyra të ndryshme se si mund të ndërmerret dhe përfundohet me sukses një nismë mbikëqyrëse. Përgjatë viteve, komisionet parlamentare kanë ndërmarrë nisma të shumta të mbikëqyrjes parlamentare dhe njëkohësisht kanë hartuar plane të ndryshme veprimi se si të përmbushet me sukses kjo detyrë.

Doracaku është përgatitur nga zyrtarë të Divizionit për Mbështetjen e Komisioneve parlamentare dhe zyrtarë të Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) dhe fokusohet vetëm në aktivitetet mbikëqyrëse në nivel të komisioneve. Gjatë përgatitjes së doracakut, grupi punues është bazuar në praktikat më të mira të Kuvendit të Kosovës, por edhe në praktikat më të mira të parlamenteve të vendeve me demokraci të zhvilluar.

Me gjithë progresin e arritur gjatë viteve të fundit, komisionet e Kuvendit vazhdojnë të përballen me shumë sfida në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, andaj synohet që përmes këtij doracaku të ndihmohet në përmirësimin e performancës së komisioneve.

Departamenti ligjor i Kuvendit do të vazhdojë të përgatisë doracakë të ngjashëm edhe për aspekte të tjera të punës në komisione dhe do të sigurohet që të shërbejnë si udhërrëfyes për deputetët dhe zyrtarët mbështetës gjatë punës në Kuvend. Me këtë rast, falënderoj anëtarët e grupit punues për përkushtimin dhe angazhimin e tyre dhe njëherësh

shprehim mirënjohjen tonë për NDI-në dhe USAID-in që kanë mbështetur përgatitjen dhe publikimin e doracakut.

**Daut Beqiri**
*Drejtor i Departamentit Ligjor*
*Kuvendi i Republikës së Kosovës*

# 2. FUNKSIONI MBIKËQYRËS I PARLAMENTIT

Paralel me funksionin përfaqësues dhe ligjvënës, mbikëqyrja e Qeverisë dhe mbajtja e saj përgjegjëse konsiderohet si një nga përgjegjësitë kryesore të parlamenteve demokratike. Para së gjithash është e drejtë dhe përgjegjësi e parlamentit që përfaqëson interesat e qytetarëve, që vazhdimisht të mbikëqyrë performancën e degës ekzekutive. Në çdo shtet me demokraci përfaqësuese të zhvilluar, organet legjislative kanë mekanizma të veçantë përmes të cilëve mbikëqyrin punën e institucioneve ekzekutive.

Qëllimi primar i mbikëqyrjes është tu mundësojë qytetarëve që përmes përfaqësuesve të zgjedhur të mbajë Qeverinë përgjegjëse për veprimet dhe mosveprimet e saj apo sukseset dhe dështimet. Ndërsa, qëllimi i dytë është t'u mundësojë anëtarëve të parlamentit të verifikojnë se sa janë të zbatueshme dhe të dobishme politikat dhe ligjet e miratuara. Ligjet dhe politikat publike të miratuara nga Parlamenti jo gjithmonë arrijnë qëllimin për të cilin janë krijuar, për shkak të gabimeve në përpilim, pengesave në implementim ose për shkak të ndryshimeve socio-ekonomike në vend. Andaj, si pjesë e funksionit mbikëqyrës, parlamenti duhet të verifikoj zbatimin e politikave dhe ligjeve, të identifikojë pengesat dhe ngecjet eventuale, dhe të propozoj marrjen e masave të nevojshme për zbatimin adekuat të tyre.

Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni i vetëm i cili zgjedhet drejtpërdrejtë nga qytetarët. Zgjedhja e Qeverisë dhe Presidentit, miratimit i ligjeve dhe emërimet e udhëheqësve të institucioneve të pavarura janë disa nga përgjegjësitë kushtetuese të Kuvendit. Njëkohësisht, Kuvendi gëzon kompetenca të gjera edhe në mbikëqyrjen e funksionimit efikas të këtyre institucioneve si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Mungesa e mbikëqyrjes efikase parlamentare, veçanërisht në vendet në tranzicion, shpesh konsiderohet si një nga arsyet e dështimit të sistemeve demokratike të qeverisjes. Në përgjithësi, roli i mbikëqyrjes efikase parlamentare konsiston në:

- Mbikëqyrjen e punës së institucioneve ekzekutive dhe institucioneve të pavarura;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe ndërmarrjen e masave konkrete për mos zbatimin e tyre;
- Mbajtjen e qeverisë përgjegjëse për mënyrën e shpenzimit të buxhetit, respektivisht taksave të qytetarëve, duke ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit;
- Zbatimin adekuat të programit dhe politikave qeveritare;
- Promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në qeverisje, si dhe rritjes të besueshmërisë së qytetarëve në organet shtetërore.

## 2.1. Roli i komisioneve

Aktivitetet kryesore të Kuvendit të Kosovës zhvillohen në nivel të komisioneve. Komisionet janë trupa punuese të cilat përbëhen nga një numër i caktuar i deputetëve dhe të cilat zakonisht pasqyrojnë përbërjen e spektrit politik në Kuvend. Komisionet mbulojnë një fushë të caktuar të politikave dhe ndër të tjera janë përgjegjëse për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve nga fushëveprimtaria e tyre, mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve, mbikëqyrjen e punës së organeve të ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura, si dhe shqyrtimin e miratimin e dokumenteve strategjike.

Komisionet parlamentare luajnë rol qendror në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës nga ana e Kuvendit. Secili komision duhet të sigurohet që ministritë që funksionojnë brenda fushës së përgjegjësive të tij, të jenë transparente dhe vazhdimisht të japin llogari para Kuvendit rreth zbatimit të politikave dhe programeve qeveritare, legjislacionit dhe para së gjithash menaxhimit të financave publike. Për të ushtruar funksionin mbikëqyrës, komisionet kanë zhvilluar mjete dhe procedura të ndryshme, si:

- Organizimi i seancave dëgjimore me përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, mediave, ekspertëve të pavarur, qytetarëve, etj.;
- Organizimi i vizitave në terren, për të parë nga afër punën e institucioneve ekzekutive apo duke u paraqitur në vendin e ngjarjes për të parë për së afërmi çështjet specifike që monitorohen;
- Koordinimi me institucionet tjera të pavarura mbikëqyrëse, si Auditori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, organizatat e shoqërisë civile, etj.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, anëtarët e komisioneve parlamentare mbështeten nga stafi i komisionit, dhe kur është e mundur ata kërkojnë edhe mbështetjen e njësive tjera të Kuvendit, si Drejtoria për Hulumtime Parlamentare, por njëkohësisht anëtarët e komisionit mund të shfrytëzojnë edhe ekspertizën e institucioneve dhe organizatave jo qeveritare dhe ekspertëve të pavarur.

## 1.2. Baza ligjore për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës

Baza ligjore për funksionin mbikëqyrës të komisioneve parashihet në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit. Këto dy dokumente bazike ofrojnë një sërë mekanizmash të cilat u mundësojnë komisioneve të ushtrojnë në mënyrë efikase funksionin mbikëqyrës. Në bazë të Rregullores së Punës, komisionet mund të kërkojnë informacione me shkrim nga ministritë, por edhe të thërrasin ministrat për të raportuar, për çështjet të cilat janë duke u trajtuar nga komisioni. Zakonisht,

komisionet themelojnë nënkomisione apo grupe punuese të veçanta të cilat angazhohen në mbikëqyrjen specifike të çështjeve nën juridiksionin e komisionit.

Edhe pse Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rolin kryesor në shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të shtetit, edhe komisionet tjera mund të ushtrojnë mbikëqyrjen e vazhdueshme të zbatimit të buxhetit dhe politikave nga ana e ministrive. Me qëllim të kontrollit më efikas të shpenzimeve qeveritare, Kuvendi ka themeluar edhe Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, raportet e të cilit paraqesin një burim të rëndësishëm për komisionet funksionale gjatë mbikëqyrjes së ministrive. Me qëllim të hetimit të çështjeve të caktuara me interes publik, Kuvendi mund të themelojë edhe komisione hetimore.

Në kuadër të funksionit mbikëqyrës, komisionet mbikëqyrin edhe zbatimin e ligjeve. Rregullorja e Kuvendit parasheh që "komisionet mund të mbikëqyrin efektivitetin e ligjeve në fuqi dhe të përgatisin rekomandime në lidhje me masat që duhet të ndërmerren për zbatimin më të mirë të ligjit. Komisionet kanë kompetenca për kontrollimin e veprimtarisë së përgjithshme të ministrive përkatëse, ndërkohë që ministrat janë të obliguar të raportojnë me shkrim dhe me gojë së paku një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit.

**Rregullorja e Kuvendit**

**Neni 73**

**Autoriteti i komisioneve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve**

1. Secili komision, brenda fushës së përgjegjësive të tij, është i autorizuar ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit nga Qeveria, përkatësisht nga ministria.
2. Ministria përkatëse i raporton komisionit funksional në lidhje me zbatimin e ligjit pa kërkesë, së paku një herë në vit.
3. Për ta ushtruar autoritetin e përmendur më lart, komisionet:
   a) Kontrollojnë dhe studiojnë efektivitetin e ligjeve në fuqi në kuadër të fushëveprimit të tyre, zbatimin e tyre dhe propozojnë masa për rastet konkrete.
   b) Përgatisin listën, që përmban: datën e shpalljes së ligjit, datën e publikimit të ligjit në Gazetën Zyrtare, listën e dispozitave të ligjit, që duhet të zbatohen nga Qeveria, listën e vendimeve të Qeverisë se këto dispozita zbatohen.
   c) Bëjnë kontrollimin e veprimtarisë së përgjithshme të ministrisë përkatëse dhe
   d) Raportojnë me shkrim dhe me gojë një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit.
4. Nëse ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet jo i plotë, me kërkesë të komisionit çështja hyn në rendin e ditës së mbledhjes tjetër plenare.

Seancat dëgjimore mbikëqyrëse janë një mekanizëm tjetër i rëndësishëm që aplikohet nga komisionet gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse. Zyrtarët e ministrive dhe institucioneve të tjera qeveritare rregullisht ftohen për të raportuar para komisioneve për aktivitetet e tyre. Seancat dëgjimore janë shumë të dobishme ngase u sigurojnë deputetëve informacione në lidhje me aktivitetet e institucioneve ekzekutive; identifikimin e sferave në kuadër të juridiksionit të komisionit që konsiderohen më të ndjeshme ndaj keqpërdorimeve apo keq menaxhimit; dhe, nëse për zgjidhjen e problemeve mjafton ndryshimi i ligjeve ekzistuese apo është e nevojshme të miratohen ligje të reja.

Seancat dëgjimore janë zakonisht të hapura për mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, mirëpo në raste të caktuara komisioni mund të vendosë të mbajë seancën me dyer të mbyllura. Duhet thekuar që në seancat dëgjimore mbikëqyrëse, komisionet mund të ftojnë edhe institucionet e pavarura. Neni 66 dhe pjesërisht neni 73 i Rregullores së Kuvendit, ofrojnë bazën ligjore për organizimin e seancave dëgjimore.

**Rregullorja e Kuvendit**

**Neni 66**
**Dëgjimet Publike**

1. Komisioni mund të mbajë dëgjim publik, për të marrë njoftime për çështje që janë në shqyrtim e sipër, me ekspertë të organizatave publike, të përfaqësuesve të grupeve të interesit dhe të personave të tjerë.
2. Për t'i sqaruar faktet komisioni mund të diskutojë gjerësisht me persona që ofrojnë njoftime.

Rregullorja e Kuvendit i jep kompetenca komisioneve për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura të themeluara nga Kuvendi. Edhe pse ka paqartësi në disa aspekte praktike, neni 72 në mënyrë specifike përshkruan procedurat për trajtimin e raporteve të këtyre institucioneve.

**Rregullorja e Kuvendit**

**Neni 72**
**Procedurat e veçanta për raportet e organeve të pavarura**

1. Raportin vjetor të punës së organit të pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi, e shqyrton komisioni funksional, që e mbulon fushën e përgjegjësisë së organit të pavarur.
2. Komisioni duhet ta shqyrtojë raportin vjetor të organit të pavarur dhe t'i paraqesë Kuvendit raport me rekomandime brenda tri javë pune, nga data që e ka marrë.
3. Shqyrtimi i raportit vjetor në mbledhjen e Kuvendit fillon me paraqitjen e raportit nga raportuesi i komisionit funksional. Pas paraqitjes së raportit, të drejtë për të diskutuar, sipas radhës, kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe deputetët, ndërsa përmbyllet me votimin për miratim.

Me gjithë sfidat e shumta, është shënuar progres i rëndësishëm në përpjekjet e komisioneve për të forcuar dhe avancuar mekanizmat e mbikëqyrjes. Në planin vjetor të punës pothuajse të gjitha komisionet përfshijnë aktivitetet me karakter mbikëqyrës. Edhe pse të stërngarkuara me shqyrtimin dhe amandamentimin e një numri të konsiderueshëm të projektligjeve, komisionet rregullisht synojnë të zbatojnë aktivitetet mbikëqyrëse si:

- Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimtaria e komisionit;
- Shqyrtimi dhe mbikëqyrja e zbatueshmërisë së buxhetit nga ministritë përkatëse;
- Mbikëqyrja e zbatimit të politikave, programeve, strategjive dhe planeve të ministrive përkatëse; dhe
- Mbikëqyrja e vazhdueshme e institucioneve të pavarura

# 3. PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE MBIKËQYRËSE

Duke marrë parasysh agjendën e ngjeshur, është e rëndësishme që në fillim të çdo viti komisionet parlamentare të planifikojnë aktivitetet e tyre mbikëqyrëse. Planifikimi i hershëm dhe sistematik i aktiviteteve të komisioneve mundëson që mbikëqyrja të ushtrohet në mënyrë më të efektshme; të bëhen përgatitjet e nevojshme; komisioni të mos ndikohet nga zhvillimet ad-hoc; si dhe të sigurohet përfshirja e akterëve të tjerë në proces, si ekspertët e pavarur dhe organizatat jo qeveritare.

## *3.1. Plani vjetor i punës*

Komisionet parlamentare e kanë bërë praktikë që në ditët e para të çdo fillimviti, të hartojnë planet vjetore të punës. Planet e punës së komisioneve bazohen kryesisht në Programin vjetor legjislativ të Qeverisë së Kosovës. Bazuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, në dhjetor të çdo viti, Qeveria është e obliguar që të aprovojë programin legjislativ, i cili përmban listën e të gjitha projektligjeve, ndarjen e tyre sipas ministrive përgjegjëse për hartimin e tyre dhe datat se kur projektligjet parashihet të pranohen në Qeveri. Programi legjislativ i dërgohet Kuvendit. Më pas komisionet parlamentare, fillojnë procedurën për hartimin e planeve të punës.

Përveç projektligjeve për shqyrtim, në planin vjetor të punës komisioni përfshinë edhe aktivitetet për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të politikave të caktuara, mbikëqyrjen e zbatimit të strategjive apo planeve të veprimit, mbikëqyrjen e ekzekutimit të buxhetit nga ana e ministrive, ndërmarrjeve publike, agjencive apo rregullatorëve të pavarur. Aktivitetet mbikëqyrëse të komisioneve të përfshira në planin vjetor të punës përmbajnë edhe datat se kur duhet të fillojë dhe kur duhet të përfundojë aktiviteti mbikëqyrës.

Planet vjetore të të gjitha komisioneve parlamentare përfshihen në Programin Vjetor të Punës së Kuvendit të Kosovës. Programi Vjetori i Punës së Kuvendit është dokument i cili përmban listën e të gjitha projektligjeve të cilat parashihet të dërgohen nga Qeveria në Kuvend dhe përmban datat e përafërta për leximin e parë dhe të dytë të projektligjeve. Përveç afateve kohore për shqyrtimin e projektligjeve në lexim të parë dhe të dytë, Programi Vjetor i Punës së Kuvendit përmban edhe afatet kohore se kur referuesit e komisioneve parlamentare do të paraqesin raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, i cili përmban përfundimet dhe rekomandimet që dalin nga aktiviteti mbikëqyrës dhe i cili do të duhej të marrë aprovimin në Kuvend.

## 3.2. Përcaktimi i aktiviteteve mbikëqyrëse

Komisionet parlamentare vlerësojnë vetë për ta mbikëqyrur një politikë, dokument strategjik, plan veprimi apo organ qeverisës. Ekzistojnë një mori ligjesh të miratuara përgjatë viteve, një numër i caktuar i institucioneve për të cilat komisionet kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë të mbikëqyrin punën e tyre, si dhe një mori e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Komisioni me rastin e vendosjes se çfarë aktivitete mbikëqyrëse të përfshijë në planin vjetor të punës, duhet t'ju jap përparësi ligjeve të cilat kanë hyrë në fuqi në një periudhë më të hershme kohore dhe zbatimi i të cilave nuk është mbikëqyrur, si dhe agjencive apo rregullatorëve për të cilat mund të ketë dëshmi se përballen me vështirësi në punën e tyre apo për të cilat është raportuar se nuk janë duke funksionuar në përputhje me ligjet në fuqi. Në procesin e identifikimit të çështjeve për t'i mbikëqyrur, komisioni mund të kërkojë edhe mbështetjen e Drejtorisë për Hulumtime Parlamentare apo organizatave partnere të shoqërisë civile dhe ekspertëve të pavarur.

## 3.3. Formimi i grupeve punuese për aktivitetet mbikëqyrëse

Brenda një viti komisionet parlamentare përballen me shumë aktivitete, si: shqyrtimi i projektligjeve, organizimi i seancave dëgjimore, vizitat studimore brenda dhe jashtë vendit, shqyrtimi i raporteve të Qeverisë dhe institucioneve të pavarura, pritjet e delegacioneve ndërkombëtare apo përfaqësues të qytetarëve, etj. Andaj, me qëllim të menaxhimit më efikas të ngarkesës së punës, komisionet parlamentare mund të krijojnë nën komisione apo grupe punuese për çështje të caktuara. Grupet punuese mund të themelohen me qëllim të shqyrtimit të një projektligji, mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve, apo politikave qeveritare.

Komisionet kanë një anëtarësi prej 9 deri 12 deputetësh, por zakonisht jo të gjithë anëtarët e komisionit angazhohen në një projekt mbikëqyrës. Komisioni cakton një grup prej 3-5 deputetësh të cilët përbëjnë grupin punues për mbikëqyrje të një ligji, politike apo institucioni. Grupi punues në përbërjen e tij duhet të ketë përfaqësues të partive nga pozita dhe opozita. Përbërjen e grupit punues në masë të madhe e përcakton edhe çështja e cila mbikëqyret dhe interesimi i deputetëve.

Si shembull, për mbikëqyrjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, në përbërje të grupit punues duhet të ketë deputet që përfaqësojnë së paku njërin nga këto grupe etnike. Apo shembulli tjetër, grupi punues për mbikëqyrjen e politikave për barazi gjinore, siç mund të jetë Ligji për Barazi Gjinore, në përbërjen e tij duhet të ketë të numër të arsyeshëm të deputeteve femra. Monitorimi i një dokumenti strategjik për rininë, siç mund të jetë Strategjia për Punësimin dhe Fuqizimin e të Rinjve, në anëtarësinë e grupit punues duhet të ketë

deputet të rinjë në moshë. Formimi i grupeve punuese për mbikëqyrje duhet të formalizohet me votim, duke siguruar mbështetjen e shumicës së deputetëve të pranishëm në mbledhje të komisionit. Grupi punues obligohet që brenda një periudhe të caktuar kohore të paraqesë me shkrim para komisionit, raportin për çështjen me të cilën është ngarkuar.

## *3.4. Hartimi i planit të veprimit për mbikëqyrje*

Grupi punues mbikëqyrës, i mandatuar nga komisioni, nga radhët e anëtarësisë së tij zgjedh kryesuesin e grupit. Kryesuesi njëherësh luan rolin e raportuesit të punës së grupit punues në komision, si dhe paraqet në seancë plenare raportin përfundimtar të miratuar nga komisioni. Grupi punues harton planin e veprimit për mbikëqyrje. Plani i veprimit duhet të shtrihet në periudhën kohore të paraparë me plan vjetor të punës së komisionit, me qëllim që ti përmbahet afatit kohor për raportim në seancë plenare, ashtu siç e parasheh Programi i Punës.

Plani i veprimit i grupit punues përfshin këto aktivitete:

- Identifikimin e obligimeve që dalin nga një ligj, dokument strategjik apo fushëveprim i një institucioni;
- Vizitat në terren për të parë nga afër zbatimin e një ligji apo politike, apo funksionimin e një organi publik;
- Thirrjen e zyrtarëve qeveritar apo udhëheqësve të institucioneve të pavarura për raportim para komisionit apo grupit punues;
- Organizimin e seancave dëgjimore me karakter mbikëqyrës

Në hartimin e planit të veprimit, grupi punues mbështetet nga stafi mbështetës i komisionit. Plani i veprimit, duhet të përfshijë edhe emrat e zyrtarëve të stafit mbështetës të komisionit të cilët do të angazhohen në asistimin e grupit punues, njësitë e Kuvendit të Kosovës të cilat mund të ndihmojnë në këtë proces, sidomos Drejtoria për Hulumtime Parlamentare, ekspertët e pavarur të fushës të cilët mund të ndihmojnë komisionin, organizatat jo qeveritare, si dhe resurset e nevojshme teknike dhe financiare që nevojiten për të zbatuar planin e veprimit.

## Grafikoni nr.1: Procesi planifikues për nismat mbikëqyrëse parlamentare



# 4. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Plani i veprimit për mbikëqyrje është udhërrëfyes për komisionin parlamentar se çfarë hapash duhet të ndjekë deri tek arritja e qëllimit final. Një plan veprimi përmban çështjet të cilat do të mbikëqyren (duke vendosur se cilave do tu jepet prioritet dhe cilat çështje do të mbesin jashtë mbikëqyrjes); si dhe kur do të zhvillohen vizitat në terren; organizimi i dëgjimeve mbikëqyrëse dhe identifikimi i personave të cilët do të ftohen për tu paraqitur në dëgjim; kyçja e akterëve tjerë në proces dhe transparenca e procesit.

## *4.1. Hulumtimet dhe analizat për çështjen nën mbikëqyrje*

Para se grupi punues të fillojë kontaktet e drejtpërdrejta me institucionet të cilat i mbikëqyrë dhe akterët tjerë relevant, nevojitet analizimi i detajuar i dokumenteve dhe materialeve të cilat kanë të bëjnë me çështjen të cilën komisioni ka vendosur ta mbikëqyrë. Stafi i komisionit, i angazhuar për të mbështetur grupin punues për mbikëqyrje, duhet të përgatisë një raport fillestar i cili shpjegon gjendjen pas hyrjes në fuqi të një ligji, dokumenti strategjik apo krijimit të një institucioni. Raporti fillestar ju shërben anëtarëve të grupit punues për të kuptuar materien e cila do të mbikëqyret dhe për të nxjerrë pyetjet e mundshme të cilat ju drejtohen zyrtarëve gjatë vizitave në terren apo me rastin e paraqitjes së zyrtarëve në seancat dëgjimore. Për shembull, raporti fillestar për mbikëqyrjen e zbatimit të një ligji të caktuar duhet të identifikojë obligimet që parasheh ligji për institucionet ekzekutive apo agjencitë e pavarura, siç mund të jenë nxjerrja e akteve nënligjore apo krijimi i trupave punuese.

## *4.2. Vizitat e grupit punues në terren*

Pas përpilimit të raportit fillestar, grupi punues fillon fazën e dytë të mbikëqyrjes, e cila përfshinë vizitat e drejtpërdrejta në institucionet ekzekutive apo në hapësirat gjeografike ku vepron ligji. Vizitat në institucionet ekzekutive me qëllim për tu takuar me zyrtarët përgjegjës, duhet të paralajmërohen. Stafi mbështetës i komisionit kontakton personat përgjegjës në institucionet ekzekutive dhe i informon ata për qëllimin e vizitës së komisionit, përbërjen e anëtarëve dhe kohën e vizitës. Vizitat të cilat kanë karakter informues për gjendjen në terren, mund të bëhen në mënyrë të pa paralajmëruar. Shembull i një vizite të tillë mund të jetë vizita në termocentrale, në miniera, apo në lumenjtë e caktuar për të parë për së afërmi se sa po zbatohet Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit.

## *4.3. Seancat dëgjimore mbikëqyrëse*

Seancat dëgjimore mbikëqyrëse të komisioneve parlamentare janë treguar mekanizëm shumë efikas gjatë ushtrimit të funksionit mbikëqyrës. Edhe pse Rregullorja e Kuvendit nuk i parasheh dëgjimet mbikëqyrëse si kategori të veçantë, neni 73 u ofron komisioneve autoritet të gjerë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe politikave qeveritare. Kjo u mundëson atyre të organizojnë dëgjime të karakterit mbikëqyrës, dhe të ftojnë ministrat, zëvendës ministrat, si dhe udhëheqësit apo zyrtarët e institucioneve të tjera shtetërore, për të ofruar shpjegime dhe informacione në lidhje me zbatimin e programeve qeveritare, problemeve të evidentuara në zbatimin e ligjeve, problemeve të ndjeshme politike apo çështje të tjera që ndërlidhen me përgjegjësitë e tyre. Gjatë dëgjimeve mbikëqyrëse, ministri ofron shpjegime dhe informacione sipas kërkesës së komisionit dhe përgjigjet në pyetjet që parashtrohen nga anëtarët e komisionit.

Në dëgjim publik ftohen edhe përfaqësuesit e qytetarëve të cilët janë të prekur nga një ligj apo politikë e caktuar; organizatat e shoqërisë civile; ekspertët e pavarur, përfaqësues të institucioneve që kanë përgjegjësinë për zbatimin e ligjit, organizata të punëtorëve, shoqata të bizneseve, etj. Anëtarët e grupit punues së bashku me stafin mbështetës identifikojnë organizatat dhe individët të cilët do të mund të jepnin kontribut në dëgjim publik. Pas identifikimit të pjesëmarrësve potencial, stafi u dërgon ftesë individuale të gjitha organizatave dhe individëve.

Ftesa dërgohet së paku një javë më parë, me qëllim që tu lihet kohë e mjaftueshme pjesëmarrësve në dëgjim publik që të përgatisin edhe raporte me shkrim. Ftesa duhet të përmbajë emrin e komisionit i cili i fton në dëgjim, vendin e mbajtjes së dëgjimit (i shoqëruar me informacione se si mund të gjendet salla e mbajtjes së dëgjimit), koha e fillimit, pjesëmarrësit tjerë potencial të cilëve u është dërguar ftesa, dhe rregullat e paraqitjes dhe marrjes së fjalës para komisionit. Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit duhet të publikohet edhe në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës dhe në mjetet e informimit.

Seancën dëgjimore mbikëqyrëse e drejton kryesuesi i grupit punues i cili njofton të pranishmit me qëllimin e mbikëqyrjes, aktivitetet e gjertanishme dhe radhën e diskutimeve në dëgjim publik, në përputhje me doracakun e Kuvendit për dëgjimet e komisioneve. Si rregull, pas kryesuesit, i jepet fjala përfaqësuesit të institucionit zbatues, puna e të cilit është objekt mbikëqyrjeje. Pas fjalës së përfaqësuesit të institucionit ndaj të cilit ushtrohet mbikëqyrja, të gjithë të ftuarve u jepen deri në 10 minuta kohë për diskutim, sipas radhës së paraqitur për diskutim, apo sipas rëndësisë që mund të ketë dëshmia e tyre. Stafi mbështetës i komisionit grumbullon dëshmitë e ofruara me shkrim, të cilat përdoren për shkrimin e raportit mbikëqyrës. Diskutimet gjatë seancës dëgjimore transkriptohen.

Seancat dëgjimore mbahen kryesisht në hapësirat e Kuvendit të Kosovës, ku ekziston mundësia më e mirë teknike për ti regjistruar dëshmitë. Por dëgjimet mund të mbahen edhe në hapësira jashtë ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, në komuna të ndryshme, me qëllim që qytetarët të kenë më të lehtë pjesëmarrjen, në rastet kur është e nevojshme prezenca e një grupi të caktuar qytetarësh. Edhe në rastet kur dëgjimet mbahen jashtë objektit të ndërtesës së Kuvendit, stafi mbështetës, përveç mbajtjes së procesverbalit, duhet të kujdeset që të regjistroj të plotë dëshmitë e pjesëmarrësve (transkriptimi).

Seancat dëgjimore janë zakonisht të hapura për mediat dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, por në raste të caktuara mund të jenë të mbyllura. Përveç institucioneve qeveritare, komisionet ftojnë në dëgjime të veçanta edhe udhëheqësit e institucioneve të pavarura që i raportojnë Kuvendit. Stafi mbështetës i komisionit, sigurohet që në bashkëpunim me Zyrën për Marrëdhënie me Media, të siguroj mbulesën mediale.

## *4.4. Angazhimi i organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të pavarur*

Përveç ftesës për të marrë pjesë në seancë dëgjimore, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e pavarur mund të angazhohen në të gjitha fazat e mbikëqyrjes. Ekzistojnë organizata të shoqërisë civile të cilat mision të punës së tyre kanë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, funksionimin e institucioneve apo zbatimit të politikave qeveritare. Andaj, grupi punues për mbikëqyrje, i ndihmuar edhe nga stafi mbështetës, identifikon organizatat e shoqërisë civile të cilat merren aktivisht me monitorimin e politikave të caktuara. Raportet e këtyre organizatave shqyrtohen dhe të gjeturat e paraqitura në to, verifikohen edhe një herë nga grupi punues.

Po ashtu, komisioni mund të vendosë që gjatë tërë procesit të mbikëqyrjes, të angazhojë edhe ekspert të pavarur. Ekspertët duhet të jenë njohës të fushës përkatëse dhe të ndihmojnë komisionin përmes analizave specifike si dhe këshillave gjatë hartimit të raporteve të komisionit. Përfshirja e ekspertëve të pavarur dhe organizatave të shoqërisë civile ndikon edhe në kredibilitetin e të gjeturave dhe rekomandimeve të prezantuara nga Komisioni në përfundim të procesit mbikëqyrës.

## *4.5. Transparenca e procesit dhe promovimi i aktiviteteve mbikëqyrëse*

Proceset mbikëqyrëse parlamentare janë një rast i mirë për të informuar publikun për aktivitetet e Kuvendit të Kosovës dhe për punën e institucioneve në përgjithësi. Andaj, komisionet parlamentare duhet të respektojnë parimin e transparencës dhe të përkujdesen që ta zbatojnë atë në punën e tyre. Transparenca në procesin mbikëqyrës duhet t'i

sigurojë qytetarët e Republikës së Kosovës, se Kuvendi, përveç miratimit të ligjeve, kujdeset se ato ligje do të zbatohen. Ashtu si qytetarët mund të shohin drejtpërdrejtë deputetët e Kuvendit duke votuar ligjet, po ashtu Kuvendi duhet të sigurohet që qytetarët të jenë të informuar edhe kur deputetët mbikëqyrin zbatimin e tyre.

# 5. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LIGJEVE

Në një demokraci parlamentare, mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjeve është po aq e rëndësishme sa edhe procesi i miratimit të tyre. Edhe pse mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjeve bëhet edhe nga shoqëria civile, vetëm institucionet publike janë përgjegjëse që të gjeturat nga aktivitetet mbikëqyrëse t'i shndërrojnë në hapa konkret për ndryshim të gjendjes faktike. Përmes mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, Kuvendi mund të nxjerr informata rreth zbatimit praktik të ligjeve, si dhe të kërkojë përgjegjësi politike nga bartësit e institucioneve nëse mësohet se institucioni zbatues nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara me ligj. Përgjatë një dekade të funksionimit të tij, Kuvendi ka miratuar mbi 300 ligje. Edhe pse është arritur të krijohet një praktikë e mirë e mbikëqyrjes së ligjeve, numri i ligjeve të monitoruara është dukshëm më i vogël se numri i ligjeve që janë në fuqi.

## *5.1. Raporti i rregullt vjetor i ministrisë për zbatimin e ligjeve*

Autoriteti i komisioneve parlamentare për mbikëqyrjen e ligjeve bazohet në nenin 73 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës. Pika dy e këtij neni obligon ministritë që të raportojnë për zbatueshmërinë e ligjeve nën juridiksionin e tyre në komisionet përkatëse parlamentare së paku një herë në vit. Rregullorja nuk përcakton afate se në çfarë periudhe kohore ministria duhet të paraqes raport para komisionit, por kjo mund të rregullohet në marrëveshje me komisionin funksional parlamentar dhe ministrinë përkatëse. Ministritë janë përgjegjëse për zbatimin e më shumë se një ligji, andaj ministria raporton veç e veç për secilin ligj ose, në marrëveshje me komisionin parlamentar, mund të dorëzojnë një raport të përbashkët për zbatueshmërine e të gjitha ligjeve.

Raporti i paraqitur nga ministria duhet të përmbajë:

- Datën e fillimit të implementimit të ligjit;
- Masat që ka ndërmarrë Qeveria për të zbatuar ligjin që nga data e hyrjes së tij në fuqi;
- Numrin e akteve nënligjore të miratuara dhe procesi i hartimit të akteve tjera nënligjore të cilat parashihen me ligj;
- Krijimi i organeve të reja (borde, departamente) të cilat parashihen me ligj;
- Kostoja financiare reale e zbatimit të ligjit (nëse kjo është e ndryshme nga Vlerësimi i Ndikimit Financiar, i përllogaritur në kohën kur projektligji është proceduar në Kuvend);
- Problemet e hasura në zbatim: vështirësitë e jashtme (pengesat në terren) apo vështirësitë e brendshme (mungesa e kapaciteteve për zbatim apo paqartësitë në interpretimin e dispozitave të ligjit);
- Planet e ministrisë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit;

Sipas pikës 4 të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, nëse ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet jo i plotë, me kërkesë të komisionit çështja hyn në rendin e ditës së mbledhjes tjetër plenare.

## *5.2. Detyrimet e komisionit para Kuvendit*

Ashtu siç është e obliguar ministria që së paku një herë në vit të paraqes raport për zbatueshmërinë e ligjeve, edhe komisionet parlamentare janë të obliguara që para Kuvendit të paraqesin raport vjetor për aktivitetet mbikëqyrëse. Neni 73, paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit parasheh që komisionet të raportojnë rreth aktiviteteve të tyre mbikëqyrëse në mbledhjet plenare të Kuvendit së paku një herë në vit. Në Programin Vjetor të Punës së Kuvendit të Kosovës, respektivisht në muajin e fundit të vitit, parashihet prezantimi i raporteve vjetore të mbikëqyrjes nga komisionet parlamentare. Raportet vjetore të komisioneve për punën e tyre mbikëqyrëse duhet të përfshijnë:

- Informata për realizueshmërinë e planit mbikëqyrës së komisionit;
- Ligjet specifike, zbatimi i të cilave është mbikëqyrur nga komisioni;
- Punën e ministrive në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe themelimin e organeve të parapara me ligj;
- Punën e ministrive në zbatimin e politikave dhe menaxhimit të buxhetit vjetor;
- Gatishmërinë e ministrive për t'iu përgjigjur thirrjeve të komisionit për raportim dhe dorëzim të dokumenteve/informatave;
- Rekomandimet kryesore të komisionit për qeverinë apo institucionet e pavarura;
- Vështirësitë në të cilat ka hasur komisioni gjatë mbikëqyrjes;
- Plani i komisionit për mbikëqyrje të vazhdueshme si dhe obligimet e ministrive për përmbushjen e rekomandimeve dhe raportim në komision për progresin e zbatimit të rekomandimeve të komisionit;
- Angazhimin e shoqërisë civile në aktivitetet mbikëqyrëse.

Si shtojcë të këtij doracaku do të mund të gjeni një model të raportit vjetor të komisionit.

## *5.3. Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve*

Në përputhje me planet vjetore të punës, komisionet me shumicë të votave vendosin për mbikëqyrjen e zbatimit të një ligji të caktuar. Pas përzgjedhjes së ligjit që do të mbikëqyret, Komisioni, cakton grupin punues prej 3 deri 5 anëtarësh dhe të cilit njëherit ia përcakton afatet kohore për përfundimin e procesit mbikëqyrës dhe përgatitjes së raportit me rekomandime. Komisioni mund të vendosë që të gjithë anëtarët të jenë pjesë e procesit mbikëqyrës dhe nuk cakton grup punues. Nga praktika e deritanishme në Kuvendin e Kosovës kemi mësuar se formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të

ligjeve ka qenë shumë më efikas për shkak të menaxhimit më të lehtë të kohës dhe aktiviteteve mbikëqyrëse.

Grupi punues, i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të përzgjedhur nga Komisioni, me mbështetje të stafit harton planin të veprimit përmes të cilit planifikon aktivitetet mbikëqyrëse. Plani i veprimit për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit duhet të përmbajë disa elemente kyçe, si:

- Pjesa hyrëse: data dhe vendi, baza ligjore për ngarkimin e grupit punues për mbikëqyrjen e ligjit, emrat e anëtarëve të grupit punues, emrat e stafit mbështetës dhe palëve të tjera të përfshira në proces;
- aktivitetet kryesore: identifikimi i obligimeve për zbatuesit, vlerësimi i përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin, organizimi i vizitave në terren, organizimi i dëgjimit mbikëqyrës, raportimi i ministrit apo zyrtarëve tjerë përgjegjës në komision, përgatitja dhe shqyrtimi i raportit me rekomandime në komision, shqyrtimi i raportit me rekomandime në seancë plenare, dhe raportimi i ministrit apo zyrtarit përgjegjës në komision për zbatimin e rekomandimeve të miratuara në seancë plenare;
- Aktivitetet specifike: në varësi të fushave që i mbulon ligji, grupi punues mund të parasheh aktivitete të ndryshme, si: zhvillimin e hulumtimeve, angazhimin e instituteve, OJQ-ve apo ekspertëve të pavarur;
- Afatin kohor për secilin aktivitet;
- Lokacionin ku do të zhvillohen aktivitetet;
- Përshkrimin e secilit aktivitet dhe personave përgjegjës;

Pas përgatitjes së planit të veprimit, grupi punues në mbështetje të stafit të komisionit, fillon implementimin e aktiviteteve të planifikuara për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. I gjithë procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit kalon nëpër katër faza:

- Faza e parë: identifikimi i obligimeve që parasheh ligji për zbatuesit dhe vlerësimi i përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin;
- Faza e dytë: organizimi i vizitave mbikëqyrëse në terren;
- Faza e tretë: raportimi i Ministrit apo zyrtarit përgjegjës në mbledhje të Komisionit, organizimi i dëgjimit mbikëqyrës, përgatitja e raportit me rekomandime nga grupi punës për mbikëqyrje, shqyrtimi i raportit me rekomandime në Komision dhe shqyrtimi i raportit me rekomandime në seancë plenare të Kuvendit;
- Faza e katërt: raportimi i ministrit apo zyrtarit përgjegjës në Komision për zbatimin e rekomandimeve të miratuara në seancë plenare në afatin e përcaktuar nga Kuvendi.

## Figurë: Skemë e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit



## a) *Identifikimi i obligimeve që parasheh ligji për qeverinë, institucionet publike dhe private*

Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit fillon me identifikimin e obligimeve që ligji i parasheh për zbatuesit e tij, e që mund të jenë: qeveria apo ministria përkatëse, institucionet e pavarura, komunat dhe institucionet private. Koordinatori i Komisionit përgatit një dokument në të cilin identifikohen obligimet për secilin institucion përgjegjës për zbatimin e tyre. Dokumenti teknikisht mund të ndahet në dy kolona. Në njërën kolonë vendoset teksti i ligjit ndërsa në kolonën tjetër identifikohen çështjet kyçe që paraqesin obligime për zbatuesit dhe të cilat gjatë procesit do të mbikëqyren. Në rastet kur ligji është i ndryshuar dhe plotësuar atëherë dokumenti ndahet në tri kolona, ku në kolonën e dytë vendoset teksti i ligjit të ndryshuar dhe plotësuar.[1]

Zyrtarët që mbështesin punën e komisionit i analizojnë në hollësi një nga një nenet e ligjit dhe i identifikojnë çështjet të cilat do të mbikëqyren. Për secilën çështje të identifikuar bëjnë komente dhe shtrojnë pyetje relevante. Ky dokument përqendrohet kryesisht në çështjet në vijim: identifikimi i akteve nënligjore që ministria duhet t'i nxjerrë në afatin e paraparë ligjor, organet apo agjencitë që parashihen të themelohen, respektimi i kushteve dhe kritereve të caktuara si dhe detyrimet tjera specifike të parapara në ligj. Dokumenti u dorëzohet anëtarëve të grupit punues të cilëve ju shërben si informacion bazik për njohjen e ligjit dhe çështjeve që duhet të mbikëqyren. Zyrtarët e komisionit në bazë të këtij dokumenti mund të hartojnë listën e pyetjeve të cilat do t'ju shërbejnë grupit punues gjatë vizitave në terren.

## b) *Vlerësimi i përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin*

Pas identifikimit të akteve nënligjore që parashihen të nxirren nga ministria apo institucionet tjera, koordinatori i komisionit përgatitë një dokument për vlerësimin e përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin në fuqi. Dokumenti teknikisht mund të ndahet në tri kolona. Në kolonën e parë vendoset teksti i dispozitave të ligjit që parashohin nxjerrjen e akteve nënligjore, në kolonën e dytë vendosen titujt dhe numrat e akteve nënligjore, ndërsa në kolonën e tretë vendoset teksti i vlerësimeve të përputhshmërisë në mes akteve dhe dispozitave ligjore.
Vlerësimi i përputhshmërisë bëhet duke krahasuar dispozitën e ligjit me dispozitat e aktit nënligjor. Fillimisht vlerësohet a është në përputhje baza ligjore e aktit nënligjor, pastaj analizohen dispozitat e aktit nënligjor një nga një dhe vlerësohet nëse ato janë në përputhje të plotë me dispozitën e ligjit apo janë në kundërshtim me të. Përvoja e deritanishme ka treguar që në mungesë të një sistemi për referimin auto-

[1] Në rastet kur është e pamundur ndarja në kolona për shkak të volumit të madh të ndryshimeve, stafi mbështetës mund të aplikoj teknika tjera më të përshtatshme për përpilimin e dokumentit mbikëqyrës.

- matik të akteve nënligjore në Kuvend që do të mundësonte mbikëqyrje sistematike të zbatimit të ligjeve, shpesh aktet nënligjore të miratuara nga institucionet ekzekutive tejkalojnë autorizimet e përcaktuara me ligj.

Gjatë procesit të vlerësimit zyrtarët e komisionit mund të konsultohen me zyrën ligjore të ministrisë dhe të kërkojnë sqarime lidhur me konfliktin e dispozitave. Dokumenti i përgatitur nga zyrtarët e komisionit përbën një informacion shtesë për grupin punues mbi zbatimin e ligjit. Mospërputhjet e identifikuara në mes të ligjit dhe akteve nënligjore paraqesin gjetjet e fazës së parë të problemeve në zbatimin e ligjit. Këto përveç që do të shkruhen si të gjetura në raport përfundimtar, shërbejnë edhe si bazë për të kërkuar nga ministria që në afatin më të shpejt t'i korrigjojë ato.

Zyrtarët e komisionit aktet nënligjore mund t'i gjejnë në faqen zyrtare të ministrisë përkatëse ose institucionit përkatës dhe duke komunikuar drejtpërdrejtë me zyrën ligjore të ministrisë ose institucionit përkatës në mënyrë zyrtare. Aktet nënligjore mund të jenë në formë të: udhëzimeve administrative, urdhëresave, rregulloreve, vendimeve apo udhërrëfyesve.

## *c) Organizimi i vizitave mbikëqyrëse në terren*

Vizitat në terren zhvillohen zakonisht pasi të jetë përfunduar hulumtimi mbi përputhjen e akteve nënligjore me ligjin dhe të jetë prezantuar para anëtarëve të grupit punues. Deri atëherë anëtarët e grupit punues kanë identifikuar aspektet problematike të ligjit si dhe zbrazëtirat eventuale në aktet nënligjore. Vizitat në institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, institucionet tjera relevante, komunitetet e caktuara apo rajone të caktuara u mundësojnë deputetëve që nga afër të monitorojnë ndikimin e ligjit dhe të identifikojnë vështirësitë eventuale gjatë zbatimit.

Anëtarët e komisionit i shfrytëzojnë vizitat në terren për të diskutuar rreth sfidave me të cilat përballen institucionet përgjegjëse gjatë zbatimit të ligjit, por njëkohësisht kërkojnë sqarime në lidhje me aktet nënligjore, veçanërisht në rastet kur ka mospërputhje me ligjin bazë. Gjithashtu, për të kuptuar më mirë gjendjen në terren, anëtarët e komisionit takohen edhe me komunitete të caktuara, grupe të interesit dhe qytetarë të zakonshëm. Për shembull, takimet me zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë, punonjësit e sektorit shëndetësor, sindikatat e punëtoreve, organizatat e caktuara të shoqërisë civile apo edhe pacientët, janë disa nga takimet e organizuara gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Shëndetësinë. Në përgjithësi, deputetët i konsiderojnë vizitat në terren shumë të dobishme ngase u mundësojnë kontakt të drejtpërdrejt me qytetarët dhe mbledhje të informatave të dorës së parë në lidhje me vështirësitë në zbatimin e ligjeve.

Para organizimit të vizitave në terren, është shumë e rëndësishme që grupi punues të informohet me detajet nga ana e zyrtarëve që mbështesin punën e komisionit. Të gjitha materialet relevante duhet të vihen në dispozicion të deputetëve së paku tri ditë para vizitës. Zyrtarët e komisionit janë përgjegjës edhe për koordinimin e takimeve dhe aspektet tjera logjistike. Gjatë vizitave në terren zyrtarët duhet të mbajnë gjithmonë shënime, dhe kur është e mundshme edhe të incizojnë diskutimet dhe më pas të përgatisin procesverbalet. Zyrtarët duhet të përgatisin edhe një komunikatë për shtyp dhe, kur është e mundshme, të sigurojnë edhe mbulimin medial të vizitës studimore.

## *d) Raportimi i ministrit apo zyrtarit përgjegjës në Komision*

Në bazë të planit të veprimit, grupi punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, mund të ftojë ministrin apo zyrtarin përgjegjës të raportojë me shkrim dhe me gojë në njërën nga mbledhjet e komisionit parlamentar për nivelin e zbatimit të ligjit përkatës. Grupi punues mund të vendosë për listën e pyetjeve që duhet t'i parashtrohen ministrit apo zyrtarit përgjegjës gjatë raportimit të tij.

Pas marrjes së vendimit për ta ftuar ministrin apo zyrtarin përgjegjës për të raportuar në Komision, kryesuesi i grupit punues në koordinim me kryetarin e komisionit, thërrasin mbledhjen e rregullt të komisionit. Koordinatori me stafin tjetër i bëjnë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbajtjen e mbledhjes. Gjithashtu, Koordinatori e njofton zyrtarisht ministrin apo zyrtarin përgjegjës për takimin së paku shtatë ditë para takimit. Të ftuarit duhet të njoftohen nga zyrtarët e komisionit hollësisht mbi qëllimin e takimit dhe të gjitha detajet tjera për takim. Gjithashtu, ai e njofton edhe njësinë për marrëdhënie me publikun dhe media për ta përcjellë takimin dhe për t'i njoftuar mediat e interesuara.

Takimin e udhëheq kryetari i komisionit, mirëpo, mund ta drejtojë edhe kryesuesi i grupit punues me autorizim të kryetarit. Kryetari apo kryesuesi i grupit punues duhet të menaxhoj kohën dhe të respektoj agjendën. Anëtarët e komisionit bëjnë pyetjet një nga një ndërsa, ministri ose zyrtari përgjegjës duhet të përgjigjet në secilën prej tyre. Gjithashtu, ministri ose zyrtari përgjegjës duhet të dorëzojë me shkrim një raport paraprak për nivelin e zbatimit të ligjit. Mirëpo, atij mund t'i kërkohet ta plotësojë raportin me çështjet që dalin nga takimi dhe ta dorëzojë atë në afatin e përcaktuar nga komisioni. Koordinatori i komisionit duhet të sigurohet që zyrtarët nën përgjegjësinë e tij janë duke marrë shënime (procesverbal) dhe duke bërë regjistrimin zanor të takimit. Këto pastaj do ti shërbejnë grupit punues si informata apo të dhëna në hartimin e raportit përfundimtar.

## e) Organizimi i dëgjimit mbikëqyrës

Me qëllim të mbledhjes së informatave për nivelin e zbatimit të ligjit, grupi punues mund të organizoj seancë dëgjimore me karakter mbikëqyrës. Në këtë mënyrë grupi punues synon të mbledhë në një tryezë të gjithë akterët kyç në implementimin e ligjit, nga të cilët pret të marrë informata dhe të dhëna shtesë për zbatimin e ligjit në praktikë. Gjithashtu, përmes dëgjimit, të gjitha palëve të interesuara ju jepet mundësia të prezantojnë argumentet e tyre për zbatimin apo mos zbatimin e ligjit në praktikë. Zakonisht në dëgjimet mbikëqyrëse ftohen përfaqësuesit e ministrisë përkatëse (përgjegjëse për zbatimin e ligjit), përfaqësuesit e institucioneve publike dhe private, organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit, ekspertët, etj.

Grupi punues e autorizon koordinatorin të filloj përgatitjet për organizimin e dëgjimit mbikëqyrës. Koordinatori në konsultim me grupin punues përgatit listën e të ftuarve për dëgjim. Përzgjedhja e të ftuarve bëhet në bazë të përgjegjësive që bartin për zbatimin e ligjit dhe atyre palëve që vlerësohet se mund të kontribuojnë me përvojën ose ekspertizën e tyre, siç mund të jenë: institutet e specializuara, ekspertët individual, kompanitë profesionale të konsulencës, etj.

Pas përgatitjes së listës për të ftuarit, koordinatori udhëzon zyrtarët mbështetës të përgatisin dhe shpërndajnë ftesat në bazë të listës. Ftesat duhet të shpërndahen së paku shtatë ditë përpara mbajtjes së dëgjimit. Ftesat mund të shpërndahen edhe përmes postës elektronike të gjithë atyre për të cilët komisioni i posedon adresat elektronike. Gjatë përgatitjes së ftesave duhet të shënohet një paragraf përmes të cilit të ftuarve ju kërkohet që dëshmitë, vërejtjet apo rekomandimet e tyre t'i sjellin me shkrim në komision. Zyrtarët duhet të përgatisin edhe një komunikatë për shtyp dhe, kur është e mundshme, të sigurojnë edhe mbulimin medial të seancës dëgjimore.

Së paku një ditë para mbajtjes së dëgjimit, koordinatori duhet të përgatisë një skenar për kryesuesin e grupit punues, të cilit do t'i ndihmoj të menaxhojë diskutimet dhe kohën. Koordinatori gjithashtu në konsultim me grupin punues duhet të përgatisë një listë me pyetje, të cilat do t'ju bëhen pjesëmarrësve në dëgjim. Në aspektin teknik stafi mbështetës i komisionit përgatit listën e nënshkrimeve, bën shënjimin e emrave për pjesëmarrës dhe përgatit të gjitha materialet e nevojshme për takim. Stafi mbështetës duhet të sigurohet që salla dhe pajisjet e zërimit dhe regjistrimit (transkriptimit) të jenë në rregull, duhet të dërgohet një listë e të ftuarve tek sigurimi në hyrje për të lehtësuar dhe orientuar hyrjen e pjesëmarrësve. Përveç, grupit punues në dëgjim mund të marrin pjesë edhe deputetë të tjerë.

Seancën dëgjimore e udhëheq kryesuesi i grupit punues. Në fillim, kryesuesi e shpallë të hapur takimin dhe flet për qëllimin e dëgjimit dhe rezultatet të cilat i pret nga ky dëgjim. Pastaj, ju jep mundësinë

pjesëmarrësve të prezantojnë argumentet e tyre për çështjen në diskutim. Kryesuesi i njofton pjesëmarrësit që koha e diskutimeve është e kufizuar deri në 10 minuta dhe kërkon nga ata të respektojnë këtë rregull. Zakonisht, pas diskutimeve vijojnë pyetjet specifike të cilat parashtrohen nga anëtarët e komisionit. Kryesuesi duhet t'ju kërkojë pjesëmarrësve që nëse i kanë të shkruara prezantimet apo dëshmitë e tyre atëherë t'i dorëzojnë tek stafi mbështetës i komisionit.

Pas përfundimit të dëgjimit, stafi mbështetës grumbullon materialet e dorëzuara me shkrim nga pjesëmarrësit. Transkripti i seancës dëgjimore dhe materialet e pjesëmarrësve të përpunuara nga stafi mbështetës i ndihmojnë grupit punues në fazat e mëtutjeshme të procesit.

## *h) Përgatitja e raportit me rekomandime*

Grupi punues i mbështetur nga stafi përpunojnë të gjitha informatat e grumbulluara nga aktivitetet e realizuara, të cilat më pas i selektojnë dhe kategorizojnë për t'i përfshirë në raportin përfundimtar. Fillimisht, koordinatori ose ndonjëri nga zyrtarët e komisionit e shkruajnë draftin e parë të raportit duke u bazuar në informatat e nxjerra deri në atë fazë. Pastaj, grupi punues mblidhet në takime ku e diskutojnë draftin në hollësi. Drafti plotësohet dhe përpunohet deri në formën përfundimtare kur edhe hidhet në votim nga grupi punues. Pas miratimit të draft-raportit, grupi punues e autorizon koordinatorin që të bëjë redaktimin e tekstit dhe ta përgatisë atë për shqyrtim në mbledhje të rregullt të komisionit.

**Përmbajtja e raportit të mbikëqyrjes së ligjit duhet t'i ketë këto elemente:**

- Hyrja
- Qëllimi i mbikëqyrjes së ligjit
- Përshkrimi i aktiviteteve të grupit punues
- Përshkrimi i problemeve të identifikuara në zbatimin e ligjit
- Rekomandimet për zbatuesit e ligjit
- Shtojcën me materialet përcjellëse[2]

## *i) Shqyrtimi i raportit me rekomandime në Komision*

Raporti i hartuar nga grupi punues duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga Komisioni në njërën nga mbledhjet e rregullta të tij. Pa miratimin e Komisionit dokumenti nuk mund të quhet raport por vetëm si draft-raport. Kryesuesi i grupi punues kërkon nga kryetari i komisionit që në njërën nga mbledhjet e komisionit ta vendosë si pikë të rendit të ditës shqyrtimin e raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

[2] Një model të raportit të mbikëqyrjes do ta gjeni në fund të doracakut tek pjesa e shtojcave.

Gjatë shqyrtimit të raportit në mbledhje të komisionit, anëtarët kanë të drejtë të diskutojnë dhe të propozojnë ndryshime dhe plotësime të raportit. Të gjitha propozimet që i japin anëtarët e komisionit, e sidomos ata që nuk kanë qenë pjesë e grupit punues, duhet t'i argumentojnë mirë në mënyrë që ato të merren parasysh nga komisioni. Në fund të gjitha propozimet për ndryshime dhe plotësime të raportit duhet të votohen një nga një me shumicë të votave. Dhe në fund, raporti duhet të votohet në tërësi. Pas procesit të votimit me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës, vlerësohet se raporti me rekomandime është miratuar. Stafi mbështetës i komisionit autorizohet që t'i përfshijë në tekstin përfundimtar të gjitha propozimet e miratuara dhe ta përgatisë raportin për procedim më tutje. Me këtë rast komisioni rekomandon që raportin ta procedojnë për në Kryesinë e Kuvendit me rekomandimin që ky raport të vendoset për shqyrtim dhe miratim në njërën nga seancat plenare të Kuvendit.

## *j) Shqyrtimi i raportit me rekomandime në seancë plenare*

Kryesia e Kuvendit e shqyrton rekomandimin e komisionit dhe e vendos në agjendë për shqyrtim në seancë plenare raportin me rekomandime për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit. Gjatë shqyrtimit të raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në seancë plenare duhet të jetë prezent edhe ministri përgjegjës për implementimin e ligjit. Në emër të komisionit raportin me rekomandime e paraqet kryetari i komisionit ose kryesuesi i grupi punues. Pas prezantimit të raportit, fjalën e marrin shefat e grupeve parlamentare të cilët pasqyrojnë qëndrimet e grupeve të tyre për raportin. Pastaj, fjalën mund ta marrin edhe deputetë të tjerë të cilët dëshirojnë të kontribuojnë në proces. Në fund të diskutimeve, raporti me rekomandime hidhet për votim dhe me të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet miratohet me shumicë të votave. Miratimi nga Kuvendi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit paraqet detyrim për Qeverinë përkatësisht ministrinë përkatëse që në afatin e përcaktuar nga Kuvendi të zbatojë rekomandimet dhe të raportojë në Kuvend lidhur me zbatimin e tyre.

## *k) Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve*

Faza e fundit e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit përfshin raportimin në komision të ministrit apo zyrtarit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të miratuara në seancë plenare. Pas përfundimit të afatit kohor për zbatimin e rekomandimeve, të përcaktuara nga Kuvendi, komisioni përgjegjës e fton ministrin apo zyrtarin përgjegjës të raportojë në komision lidhur me implementimin e rekomandimeve të miratuara në seancë plenare.

Komisioni kërkon nga ministri informata dhe argumente nëse janë implementuar rekomandimet. Në rast se nuk janë implementuar, atëherë

komisioni kërkon përsëri nga ministri që në afatin sa më të shpejtë t'i implementojë ato rekomandime. Gjithashtu, komisioni do ta ngritë si çështje edhe në seancë plenare mos zbatimin e rekomandimeve nga ministria. Ky lloj i raportimit tanimë ka filluar të zbatohet në Kuvendin e Kosovës. Kjo është një formë e mirë përmes së cilës komisioni mundet të përmbushë qëllimin e tij në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës.

# 6. Mbikëqyrja e Buxhetit

E drejta për të autorizuar mbledhjen e të hyrave dhe shpenzimin e parasë publike është një nga kompetencat më të rëndësishme të Kuvendit. Njëkohësisht, Kuvendi ka rol qendror në mbikëqyrjen e shpenzimit të parasë publike. Mbikëqyrja efikase e ekzekutimit të buxhetit ndihmon në përmirësimin e praktikave menaxhuese me buxhetin shtetëror, zvogëlimin e dallimeve në mes të parasë në dispozicion dhe parasë së shpenzuar, si dhe, më e rëndësishmja për vendin tonë, parandalon korrupsionin. Gjithashtu, mbikëqyrja e buxhetit ndihmon Kuvendin që të kuptojë më mirë nevojat buxhetore të sektorëve të caktuar dhe të penalizojë me mos ndarje të buxhetit organizatat buxhetore të cilat nuk e shpenzojnë si duhet buxhetin e ndarë në vitin paraprak (kanë suficit buxhetor apo planifikim jo të mirë).

## *6.1 Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës*

Ligji për Buxhetin e Kosovës është një nga ligjet më të rëndësishme të cilin e miraton Kuvendi i Kosovës. Këtë të drejtë Kuvendi e bazon në nenin 65, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës sipas së cilës "Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës." Sipas Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria është e obliguar që jo më vonë se më 31 tetor të çdo viti fiskal të dërgoj në Kuvend për miratim Draft-buxhetin e Kosovës dhe Draft-ligjin për Ndarjet Buxhetore.[3] Ligji mbi Ndarjet Buxhetore miratohet nga Kuvendi me të cilin autorizohen organizatat buxhetore për shpenzimin ose bartjen e fondeve publike, deri në një kufi të caktuar dhe për qëllime të caktuara, gjatë vitit fiskal.[4]

Përveç të drejtës për aprovim të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Kuvendi ka të drejtë edhe të:

- Autorizoj zgjatjen e kohës së zbatueshmërisë së Ligjit për Ndarjet Buxhetore të vitit të kaluar fiskal, në rrethanat e parapara me nenin 24 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Autorizoj transferimin e shumave buxhetore më të mëdha se 25% e buxhetit të ndarë për atë kategori të caktuar ;[5]
- Miratoj ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Buxhetin, nëse shpenzimet apo të hyrat në Buxhetin e Kosovës janë më të ulëta ose më të mëdha se sa ato që janë paraparë me ligj; [6]

[3] Neni 22 pika 1 e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
[4] Neni 1 pika 1 e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
[5] Neni 30.4 i Ligjit nr.03/L-048 dhe Neni 8 i Ligjit nr.03/L-221.
[6] Neni 25 i Ligjit nr.03/L-048 dhe Neni 8 i Ligjit nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

- Miratoj Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, e cila përgatitet nga Qeveria dhe dërgohet në Kuvend jo më vonë se deri më 30 prill të secilit vit kalendarik;[7]

Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF) është komisioni përgjegjës parlamentar për shqyrtimin dhe amendamentimin e Draft-ligjit për Buxhetin. KBF është komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësive, i shqyrton të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me buxhetin dhe me financat në Kosovë.[8] Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministritë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.[9]

Përveç Komisionit për Buxhet dhe Financa, edhe komisionet tjera të përhershme dhe funksionale mund të organizojnë dëgjime buxhetore për të shqyrtuar draft buxhetet e ministrive të cilat ato mbulojnë apo institucioneve të pavarura. Angazhimi i komisioneve tjera parlamentare, përveç atij për Buxhet dhe Financa, është i domosdoshëm sidomos me rastin e shqyrtimit të buxheteve të institucioneve të pavarura. Kuvendi i Kosovës, si themelues i institucioneve të pavarura, e ka të drejtën për shqyrtimin, amendamentimin dhe aprovimin e buxhetit të këtyre institucioneve. Gjatë procesit të buxhetimit për një agjenci të pavarur me të hyra të përcaktuara, as ministri dhe as Qeveria nuk janë të autorizuara që të bëjnë ndryshimin e propozim-buxhetit ose kërkesës për ndarje buxhetore të një agjencie të pavarur. Ministri dhe Qeveria duhet të sigurojnë që të gjitha propozim-buxhetet e institucioneve të pavarura dhe kërkesa për ndarje të buxhetit të inkorporohen, pa ndryshime, në Draft-buxhetin e Kosovës dhe Draft-ligjin për Ndarjet Buxhetore, dhe t'i dorëzohen Kuvendit.[10]

Andaj, mënyra më e drejtë e shqyrtimit të buxhetit të institucioneve të pavarura, duke mos rrezikuar pavarësinë e këtyre institucioneve, është shqyrtimi i draft-buxheteve në kuadër të komisioneve funksionale. Pas dëgjimeve buxhetore, komisionet parlamentare dërgojnë rekomandimet e tyre tek KBF. Komisionet parlamentare dhe Kuvendi në përgjithësi nuk kanë përgjegjësi dhe të drejtë pjesëmarrjeje në planifikimet buxhetore. Kjo e drejtë dhe përgjegjësi bie mbi ekzekutivin. Mirëpo, Kuvendi dhe komisionet mund të luajnë rol të madh në ndarjet buxhetore, në momentin kur Qeveria dërgon Draft-ligjin për buxhetin në Kuvend. Për të qenë procesi i shqyrtimit dhe amendamentimit të buxhetit më efikas, komisionet parlamentare duhet të kërkojnë hulumtime dhe analiza paraprake për përmbajtjen dhe ndikimin që mund të ketë Draft-buxheti për vitin pasardhës fiskal. Hulumtimet dhe analizat mund të përqendrohen në:

[7] Neni 19 i Ligjit nr.03/L-048 dhe Neni 5 i Ligjit nr.03/L-221.
[8] Për fushëveprimtarinë e komisionit, referojuni Shtojcës I të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.
[9] Rregullorja e Kuvendit të Kosovës: Shtojca nr.2 – Fushëveprimi dhe Përgjegjësitë e Komisioneve Parlamentare. 29 prill 2010.
[10] Neni 66 i Ligjit nr.03/L-048.

- **Analizat sektoriale** të cilat mund të ndihmojnë komisionet parlamentare për të kuptuar se buxheti i propozuar a është në vijë me prioritetet e proklamuara nacionale, siç mund të jetë integrimi evropian. Duke analizuar shpenzimet sipas sektorëve, parlamentarët mund të kuptojnë më mirë se cilëve sektorë u është dhënë më shumë përparësi, si: arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes, infrastrukturës, etj.

- **Analiza gjeografike** e cila ndihmon komisionet të kuptojnë më mirë shpërndarjen gjeografike të investimeve, a u është dhënë përparësi e njëjtë për nga investimet të gjitha komunave të Kosovës në proporcion me numrin e popullsisë, territorin dhe nevojat urgjente për subvencione të qeverisë;

- **Analiza mbi efektin që mund të ketë buxheti në grupe të caktuara të shoqërisë**, apo si do të ndikojnë ndarjet buxhetore në familjet me raste sociale, pensionistët, minoritetet, banorët e zonave të thella malore, etj.

Të gjitha këto ndihmojnë komisionet parlamentare për të kuptuar përmbajtjen e përgjithshme të Draft-buxhetit, të marrin vendime për ndryshime dhe plotësime, si dhe mbikëqyrjen më efikase të zbatueshmërisë së buxhetit gjatë vitit. Me rastin e propozim-ndryshimeve në Draft-buxhetin e një institucioni, zyrtarët e komisionit duhet të kujdesen që të hartojnë qartë dispozitat që parashohin ndryshime. Gjithashtu, zyrtarët duhet të kujdesen që ndryshimet në një linjë buxhetore, të reflektohen pastaj edhe në buxhetin total të atij institucioni. Përveç kësaj, propozim ndryshimet në linjat buxhetore duhet të shoqërohen edhe më një arsyetim të komisionit. Arsyetimi për propozim ndryshimet në buxhet jepet nga deputetët e komisionit, ndërkohë që teknikisht përgatitet nga ana e zyrtarëve mbështetës. Është me rëndësi të theksohet që zyrtarët e komisioneve duhet të kujdesen që me rastin e diskutimit të Draft-buxhetit të një agjencioni, të jenë të ftuar zyrtarët e institucionit përkatës, zyrtarët e Ministrisë së Financave dhe një zyrtar mbështetës i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

## *6.2 Raportimi i organizatave buxhetore në Kuvend*

Pas miratimit të ndarjeve buxhetore nga ana e Kuvendit, Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Buxhetin, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe ligjet themeluese të institucioneve të pavarura, obligojnë institucionet ekzekutive dhe ato të pavarura që të raportojnë në baza të rregullta tre mujore dhe vjetore për shpenzimet dhe të hyrat buxhetore.

Ligji i buxhetit për çdo vit fiskal parasheh edhe raportimin e rregullt për shpenzimet dhe të hyrat buxhetore para Kuvendit dhe komisioneve. Për shembull, Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2012 parasheh që: "në çdo kohë kur kërkohet nga Kuvendi, Ministri, në emër të Qeverisë,

prezanton para Kuvendit raportin gjithëpërfshirës që ofron detajet dhe barazimin e ndarjeve buxhetore të aprovuara për vitin 2012, dhe të gjitha transferet pasuese dhe ndryshimet tjera, dhe ndarjet buxhetore finale për vitin fiskal 2012".[11]

Qeveria është e obliguar që t'i dorëzojë Kuvendit një raport mbi secilën organizatë buxhetore brenda tridhjetë ditëve pasi që ky raport t'i jetë dorëzuar Qeverisë nga organizata përkatëse buxhetore.[12] Ministri do të përgatitë dhe Qeveria do të shqyrtojë raportet tremujore që mbulojnë vitin fiskal për çdo çerek viti të përfunduar. Raportet e tilla do t'i parashtrohen Kuvendit brenda 30 ditëve nga mbarimi i çdo çerek viti dhe të publikohen nga Ministri.[13] Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Ministri do të përgatit dhe dorëzoj Qeverisë, për miratim dhe dorëzim në Kuvend, një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet paraprake fiskale.[14]

Po ashtu, edhe Auditori i Përgjithshëm do të përgatisë dhe t'i dorëzoj Kuvendit një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike për vitin e kaluar fiskal. Ky raport do të parashtroj opinionet e Auditorit të Përgjithshëm mbi atë se nëse deklaratat financiare të organizatave të këtilla buxhetore japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të financave të këtyre organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike.[15]

Edhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit është i detyruar që në bazë vjetore, t'i dorëzoj Kuvendit një raport vjetor mbi të gjitha çështjet që ndërlidhen me veprimtarinë e Thesarit si dhe zbatimin e Rregullave KMF dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Ky raport duhet të përmbaj një dispozitë (i) në të cilën përshkruhen problemet kryesore në veprimtarinë e Thesarit, zbatimin e Rregullave KMF dhe Buxhetit të Kosovës, dhe (ii) në të cilën Drejtori i Përgjithshëm jep rekomandime për zgjidhjet e mundshme të këtyre problemeve.[16] Në shtojcën 7 janë përshkruar në mënyrë tabelare afatet kohore të buxhetimit, obligimet e qeverisë dhe angazhimet e Kuvendit në këtë proces.

---

[11]Neni 3 pika 3 e Ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.
[12]Neni 44.6 i Ligjit nr.03/L-048.
[13]Neni 45.1 i Ligjit nr.03/L-048.
[14]Referoju nenit 45.1 të Ligjit nr.03/L-048 për atë se qfarë duhet të përfshij raporti i Qeverisë për shpenzimet vjetore të buxhetit.
[15]Po aty, neni 47.1.
[16]Po aty, neni 4.9.

## 6.3 Mbikëqyrja e zbatimit të buxhetit nga komisionet parlamentare

Kuvendi dhe komisionet kanë të drejtën e shqyrtimit dhe aprovimit të buxhetit të shtetit. Po ashtu Kuvendi, përmes ligjeve në fuqi, obligon Qeverinë dhe organizatat buxhetore veç e veç, të raportojnë në baza të rregullta për shpenzimet dhe të hyrat buxhetore. Pas miratimit përfundimtar të buxhetit, komisionet parlamentare duhet të mbikëqyrin zbatueshmërinë e buxhetit, duke u bazuar në raportet tre, gjashtë, nëntë mujore dhe raportin përfundimtar vjetor të buxhetit. Monitorimi i menaxhimit të buxhetit, ndihmon komisionin që gjatë shqyrtimit të buxhetit të ardhshëm vjetor, të jetë më i përgatitur rreth nevojave buxhetore të atij institucioni. Gjatë monitorimit të zbatueshmërisë së buxhetit, komisioni parlamentar duhet të ketë parasysh këto aspekte:

- A është arritur plani i të hyrave vjetore buxhetore? Nëse jo, cilat janë pengesat e mos realizimit të të hyrave të parapara buxhetore?
- Si është shpenzuar buxheti sipas kategorive, si: kategoria e pagave, mallra dhe shërbime, investime kapitale?
- A shpenzohet buxheti njëtrajtshëm përgjatë tërë vitit, apo ka periudha kohore kur buxheti shpenzohet më shumë se në periudhat tjera (siç është rasti i shpenzimeve për kategorinë e investimeve kapitale)?
- A është i mjaftueshëm buxheti i ndarë apo kërkohet buxhet shtesë për vitet në vijim?
- Në rast të tepricave buxhetore, një gjë e tillë ndodh si pasojë e paaftësisë së institucionit për të menaxhuar me buxhetin e saj, apo institucioni mund të funksionoj me më pak buxhet vjetor?
- Cilat janë të gjeturat kryesore në raportin e Auditorit Gjeneral dhe çfarë thonë raportet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për institucionin?

Kjo formë e mbikëqyrjes së buxhetit, ndikon direkt në rritjen e performancës së institucioneve në menaxhimin më të mirë të buxhetit, si dhe shmang praktikën e keqpërdorimit të buxhetit dhe rasteve korruptive.

## a. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Shumica e vendeve demokratike kanë krijuar komisione të veçanta parlamentare përgjegjëse për të mbikëqyrur integritetin, ekonomitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit të financave nga ana e Qeverisë, përmes ekzaminimit të dokumenteve financiare dhe shqyrtimit të raporteve të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Një shembull të tillë e ka ndjekur edhe Kuvendi i Kosovës, kur më 2009 ka themeluar Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) ka kryesisht rol mbikëqyrës. Komisioni është duke ndërtuar kapacitetet e nevojshme administrative

për të ushtruar funksionin e tij mbikëqyrës. Komisioni e ka të drejtën të thërret në dëgjime mbikëqyrëse zyrtarët e institucionit, pasqyrat financiare të të cilëve janë audituar, dhe kërkon llogari për të gjeturat e auditorit. Varësisht nga raporti i auditorit, Komisioni mund të dalë me rekomandime për ndërmarrjen e masave për zyrtarët të cilët nuk kanë implementuar buxhetin si duhet, ashtu siç parashihet me Ligjin për buxhetin dhe ligjet tjera mbi financat publike. Komisioni mund të bashkëpunoj edhe me komisionet tjera parlamentare, kur komisionet ndërmarrin iniciativën për të mbikëqyrur zbatimin e buxhetit nga ana e ministrive, ndërmarrjeve publike, agjencive të pavarura apo rregullatorëve.

## *b. Mbikëqyrja e buxhetit nga komisionet tjera*

Mbikëqyrja parlamentare e zbatimit të buxhetit ndihmon në rritjen e transparencës për mënyrën e shpenzimit të parasë publike; ndihmon në rritjen e kontrollit dhe uljen e praktikave të keq menaxhimit të parasë dhe rasteve korruptive. Për këtë arsye, komisionet duhet të ushtrojnë rolin e tyre kushtetues për të mbikëqyrur zbatueshmërinë e buxhetit. Andaj, komisionet parlamentare, përveç mbikëqyrjes së programeve, ligjeve dhe politikave të cilat institucionet i zbatojnë, mbikëqyrin edhe se si zbatohet buxheti i atij institucioni dhe sa është i ndërlidhur buxheti me prioritetet dhe strategjitë e atij institucioni.

Procesi buxhetor është mjaft kompleks dhe është e pamundur që të gjitha komisionet të punësojnë në stafin e tyre profesionist të cilët njohin mirë procesin buxhetor dhe të cilët do të ishin përgjegjës për të asistuar komisionin në mbikëqyrjen e zbtueshmërisë së buxhetit të një institucioni të caktuar. Në mungesë të kësaj, komisionet parlamentare, gjatë punës së tyre mbikëqyrëse shfrytëzojnë ekspertizën dhe mbështetjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Drejtorisë për Hulumtime Parlamentare, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të pavarur.

Përveç formave të rregullta të raportimit nga institucionet, komisionet parlamentare, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së buxhetit mund të kërkojnë informata shtesë. Këto informata shtesë mund të përfshijnë:

- Numrin e përgjithshëm të të punësuarve dhe nivelin e pagave për secilin punonjës;
- Shpenzimet për reprezentacion dhe informata më të hollësishme se kush sa ka shpenzuar për reprezentacion, në çfarë takimesh dhe arsyeshmërinë e këtyre shpenzimeve;
- Informata të detajuara për shpenzimet e komunikimit, numrin e telefonave të blerë dhe shpenzimet e komunikimit për telefona mobil dhe fiks;
- Numrin e automjeteve zyrtare, rregullat për përdorimin e tyre,

kilometrat e kaluara, karburantet e shpenzuara, individët brenda institucionit të cilët kanë përdorur këto të drejta dhe arsyeshmërinë e tyre;
- Shpenzimet për vizitat jashtë vendit, arsyeshmërinë e vizitave, numrin e pjesëmarrësve në këto vizita, etj.

Institucionet janë të obliguara që tu përgjigjen komisioneve parlamentare me saktësi dhe me kohë në kërkesat e tyre për informata shtesë për mënyrën e shpenzimit të buxhetit. Figura më poshtë paraqet ciklin e hartimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit, nga tre aktorë dhe tri nivele të ndryshme të kontrollit dhe mbikëqyrjes.




## 6.4 *Mbikëqyrja e zbatimit të strategjive të Qeverisë*

Pas ligjeve dhe akteve nënligjore, edhe dokumentet strategjike dhe planet e veprimit luajnë rol të rëndësishëm në fushëveprimtarinë e institucioneve. Qeveria e Kosovës ka aprovuar me dhjetëra strategji dhe plane të veprimit. Shumica e strategjive dhe planeve të veprimit janë aprovuar me vendime të Qeverisë së Kosovës. Por, aty ku e parashohin ligjet në fuqi, një numër i strategjive nevojitet që të marrin edhe aprovimin e Kuvendit para se ato të hyjnë në fuqi.

Dokumentet strategjike vënë objektivat zhvillimore që duhet t'i arrijë një institucion brenda një periudhe të caktuar. Planet e veprimit shërbejnë për konkretizimin e objektivave dhe parashikimin e hapave, afatet kohore të detajuara, institucionet përgjegjëse për zbatim dhe koston e secilit veprim.

Edhe pse Kuvendi nuk vendos për pjesën më të madhe të përmbajtjes së strategjive dhe planeve të veprimit, ato përmbajnë informacione dhe objektiva të rëndësishme, mbikëqyrja e të cilave rrit presionin ndaj institucioneve për t'i zbatuar ato. Arsye tjetër se përse komisionet mbikëqyrin zbatueshmërinë e strategjive dhe planeve të veprimit janë edhe fondet publike, të cilat alokohen për përmbushjen e aktiviteteve që parashihen me plan veprimi.

Në fillim të vitit, anëtarët e komisionit, në koordinim me stafin mbështetës identifikojnë strategjitë, zbatimi i të cilave do të monitorohet gjatë vitit. Me këtë rast, komisioni duhet tu jap përparësi strategjive të aprovuara më herët dhe zbatueshmëria e të cilave shtrihet për periudha të gjata kohore. Stafi i komisionit, duhet të përgatis një plan të mbikëqyrjes, i cili përfshin shqyrtimin e të gjitha dokumenteve relevante, vizitave në terren, seancave dëgjimore me zyrtarët qeveritar përgjegjës për zbatimin e strategjisë si dhe takime me qytetarë dhe organizata të shoqërisë civile. Gjatë mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së strategjive, komisioni duhet të fokusohet në çështjet në vijim:

- A janë arritur objektivat e përcaktuara në strategji?
- A janë siguruar fondet e nevojshme për implementimin e strategjisë? Nëse jo, si planifikon Qeveria të siguron fondet?
- Performanca e institucioneve përgjegjëse për zbatueshmërinë e planit të veprimit dhe arritjen e objektivave strategjike?
- Cilat janë kapacitetet, vështirësitë dhe sukseset e këtyre institucioneve?

Varësisht nga rezultatet përfundimtare të mbikëqyrjes, raporti monitorues i komisionit mund të përmbaj rekomandime të cilat i sugjerojnë Qeverisë së Kosovës rishikimin e strategjisë në pika të caktuara. Edhe pse strategjitë janë dokumente nën përgjegjësinë e ekzekutivit, Kuvendi duhet të kujdeset për zbatueshmërinë e tyre, ngase implementimi i këtyre strategjive kërkon mjete buxhetore, për të cilat vendos Kuvendi. Në shtojcën 6 të këtij doracaku, mund të gjeni listën e të gjitha strategjive të cilat janë në fuqi, datën e miratimit të tyre në Qeveri, datën e miratimit në Kuvend, nëse një strategji e tillë është dërguar në Kuvend për miratim, institucioni zbatues dhe komisioni përgjegjës funksional për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së strategjisë dhe planit të veprimit.

## *6.5 Roli i Kuvendit në adresimin e sfidave të Raportit të Progresit për Kosovën*

Komisioni për Integrime Evropiane është komision i përhershëm. Komisioni ka kryesisht rol mbikëqyrës të proceseve integruese evropiane dhe harmonizues i ligjeve dhe politikave vendore me ato të legjislacionit të përbashkët evropian. Komisioni monitoron zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). PVPE është

dokument strategjik i Qeverisë së Kosovës i cili aprovohet për çdo vit që nga 2008. Qëllimi i PVPE është adresimi i sfidave të identifikuara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën. Koordinuese dhe mbikëqyrëse e PVPE në nivel qeveritar është Ministria e Integrimeve Evropiane (MIE). Komisioni për Integrime Evropiane, në koordinim me komisionet tjera funksionale, mbikëqyrë në baza të rregullta zbatueshmërinë e PVPE.

Po ashtu Komisioni për secilin vit, harton dhe mbikëqyrë zbatueshmërinë e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrime Evropiane. Pas publikimit të raportit të përvjetshëm të Komisionit Evropian për progresin e arritur në Kosovë dhe sfidat që mbeten për tu zgjidhur, KIE fillon procedurën e hartimit të planit të Kuvendit për veprim për zgjidhjen e sfidave të cilat janë përmendur nga Raporti i Progresit për Kosovën.

Plani i Veprimit të Kuvendit për Integrime Evropiane përfshinë:

- sfidat e Raportit të Progresit për Kosovën;
- institucionet përgjegjëse ekzekutive të cilat janë përgjegjëse për ballafaqimin me këto sfida;
- komisionet përgjegjëse parlamentare të cilat marrin përsipër që të thërrasin në dëgjime mbikëqyrëse zyrtarët e institucioneve për të raportuar lidhur me progresin e arritur në zbatimin e sfidave të raportit të progresit;
- afatet kohore kur komisionet thërrasin zyrtarët ekzekutiv për tu paraqitur në mbledhjet e komisionit për të raportuar;
- afatet kohore kur Komisioni për Integrime Evropiane, pasi të ketë mbledhur raportet mbikëqyrëse edhe nga komisionet tjera, paraqet raport të rregullt tre mujor para Kuvendit të Kosovës për zbatueshmërinë e Planit të Veprimit për Integrime.

Pas identifikimit të sfidave dhe komisioneve përgjegjëse parlamentare, komisionet përfshijnë aktivitetet e parapara me Plan të Veprimit të Kuvendit për Integrime në planet e tyre vjetore të punës. Komisionet sipas afateve të parapara kohore, thërrasin zyrtarët qeveritar për raportim. Ftesat për paraqitje në komision përmbajnë edhe çështjet (sfidat) për progresin e zbatueshmërisë të së cilave duhet të raportoj bartësi i institucionit ekzekutiv. Në takimet e tilla mbikëqyrëse, për të raportuar në mënyrë të pavarur, mund të ftohen edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe ekspert të pavarur.

Pas mbledhjes së dëshmive dhe raporteve, secili komision funksional harton raport të cilin ia dërgon KIE, kurse KIE pas mbledhjes së raporteve nga të gjitha komisionet, paraqet raport tre mujor para Kuvendit për zbatueshmërinë e Planit të Veprimit të Kuvendit për Integrime Evropiane.

# 7. Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura

Institucionet e pavarura janë institucione të themeluara nga Kuvendi i Kosovës, përmes ligjeve të cilat njëkohësisht përcaktojnë fushëveprmitarinë e tyre. Quhen të pavarura ngase këto institucione për veprimtarinë e tyre janë përgjegjëse vetëm para Kuvendit të Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh ekzistimin e së paku pesë institucioneve të pavarura:

1. Avokati i popullit;
2. Auditori i Përgjithshëm;
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
4. Banka Qendrore;
5. Komisioni i Pavarur i Mediave.

Kuvendi i Kosovës e ka të drejtën e themelimit të institucioneve të pavarura, përveç atyre të cekura në Kushtetutë, të cilat mund të jenë agjenci apo rregullatorë të pavarur. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, agjencitë e pavarura i përkufizon si institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligjin. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin.[17] Rregullatorët e pavarur janë institucione të cilat vënë rregulla për operimin në fusha të ndryshme të tregut, si energjia, telekomunikacioni, transporti, etj.

Në praktikën e deritanishme, Kuvendi është përballur me shumë sfida sa i përket raporteve me institucionet e pavarura. Disa nga këto sfida kanë qenë: baza jo e qartë ligjore për raportim dhe llogaridhënie, mos koordinimi në mes Qeverisë dhe Kuvendit për të zgjedhur me kohë anëtarët e bordeve, si dhe mos përcaktimi i mënyrës së mbajtjes në përgjegjësi të anëtarëve të bordeve. Edhe pse institucionet e pavarura janë përgjegjëse vetëm para Kuvendit të Kosovës, Qeveria e Kosovës bënë përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të bordeve të këtyre institucioneve, kurse Kuvendi përzgjedh në mesin e kandidatëve të propozuar nga Qeveria.

Në të shumtën e rasteve praktika e këtillë e përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve ka krijuar polemika të shumta, pasi që deputetë të partive politike të përfaqësuara në Kuvend janë ankuar se shpeshherë ju duhet të përzgjedhin në mes të kandidatëve politik në njërën anë, si dhe kandidatëve të pakualifikuar, në anën tjetër. Mirëpo, sfida më e madhe deri më tani ka qenë mungesa e mbikëqyrjes efikase të punës së institucioneve të pavarura nga ana e Kuvendit.

[17] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 145.

## *7.1 Përgjegjësia e Kuvendit në raport me institucionet e pavarura*

Si themelues i institucioneve të pavarura (agjencive dhe rregullatorëve), Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësinë që këtyre institucioneve tu sigurojë kushte për punë, si: hapësirat e punës, buxhetin dhe emërimin e anëtarëve në pozitat drejtuese. Vetëm Kuvendi i Kosovës është përgjegjës për buxhetin përfundimtar të institucioneve të pavarura. Gjatë procesit të buxhetimit për një agjenci të pavarur me të hyra të përcaktuara, as Ministri dhe as Qeveria nuk janë të autorizuara që të bëjnë ndryshimin e propozim-buxhetit ose kërkesës për ndarje buxhetore të një agjencie të pavarur ose gjykatave, nëse ky dokument është dorëzuar deri në datën e përcaktuar në qarkoren buxhetore dhe në përputhje me formën e kërkuar në qarkore. Nëse dokumenti nuk i është dorëzuar Ministrisë së Financave deri në datën e përcaktuar, Ministri është i autorizuar që të përgatisë propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore për agjencinë përkatëse të pavarur të cilat duhet të bazohen, mirëpo të mos jenë më shumë, se buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore për vitin aktual fiskal.[18]

## *7.2 Miratimi i buxhetit të institucioneve të pavarura*

Draft-buxheti i përpiluar nga institucionet e pavarura, sipas formës së përcaktuar në qarkoret buxhetore, i dërgohet Ministrisë së Financave (MF). MF duke mos  pasur të drejtën e intervenimit në Draft-buxhetin e institucionit të pavarur, e përfshinë projektbuxhetin e institucionit të pavarur në Tabelat Buxhetore të cilat i dërgohen Qeverisë dhe Kuvendit për aprovim.

Pas aprovimit të Projektligjit për Buxhetin në lexim të parë në seancë parlamentare, Komisioni për Buxhet dhe Financa, kërkon nga komisionet tjera funksionale që të shqyrtojnë projektbuxhetin e institucionit të pavarur, që është nën juridiksionin e tyre. Komisionet funksionale thërrasin për raportim drejtuesit e institucionit të pavarur. Pas shqyrtimit të projektbuxhetit të institucionit të pavarur, komisionet funksionale hartojnë një raport në të cilin paraqesin ndryshimet që komisioni propozon që të bëhen në projektbuxhetin e institucionit të pavarur.  Kjo u mundëson anëtarëve të komisionit të kuptojnë më mirë alokimin e buxhetit të brendshëm të institucioneve të pavarura, dhe mbikëqyrjes më efikase përgjatë vitit në vijim. KBF e ka të drejtën që të pranojë, të ndërhyjë apo të refuzojë rekomandimet e komisionit funksional lidhur me projektbuxhetin. Pas shqyrtimit të projektbuxheteve për secilin institucion të pavarur, KBF përcjell Projektligjin për Buxhetin së bashku me Ndarjet Buxhetore për aprovim në lexim të dytë në Kuvend.

---

[18] Neni 66, pika 1 e Ligjit nr.03/L-048.

Praktika e deritanishme e shqyrtimit të raporteve financiare nga ana e komisioneve parlamentare ka treguar disa mangësi. Raporti financiar i institucionit është shqyrtuar dhe aprovuar ende pa u bërë publik raporti i Auditorit të Përgjithshëm. Në disa raste, komisioni parlamentar ka aprovuar pa vërejte raportin financiar, kurse raporti i auditimit ka gjetur parregullsi në menaxhimin e buxhetit. Andaj, zyrtarët mbështetës të komisioneve parlamentare me ndihmën edhe të Drejtorisë për Hulumtime Parlamentare, me rastin e shqyrtimit te raportit financiar të institucionit të pavarur, duhet të përgatisin një raport përmbledhës për perfomancën buxhetore të viteve të kaluara, duke u fokusuar në të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Në këtë mënyrë anëtarët e komisionit parlamentar do të mund të ushtrojnë mbikëqyrje më efikase të buxhetit.

## *7.3 Emërimi i udhëheqësve të institucioneve dhe anëtarëve të bordeve*

Kuvendi i Kosovës, përmes komisioneve funksionale, e ka të drejtën e emërimit të zyrtarëve në pozitat e larta drejtuese në institucionet e pavarura. Procedurat për përzgjedhjen e zyrtarëve drejtues në institucionet e pavarura janë të ndryshme. Rregullat e selektimit dhe emërimit të zyrtarëve udhëheqës të këtyre institucioneve përcaktohen me ligjin i cili themelon institucionin e pavarur. Por në përgjithësi, ekzistojnë dy mënyra të përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të pavarura:

1. Qeveria shpall konkurs për plotësimin e pozitave udhëheqëse në institucionin e pavarur, udhëheq procesin e selektimit dhe intervistimit, emrat e kandidatëve më të mirë i dërgohen Kuvendit për aprovim përfundimtar;
2. Kuvendi vet i ndërmerr të gjitha procedurat e nevojshme: shpalljen e konkursit, intervistimin, përzgjedhjen.

Mandati i anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura ndryshon nga institucioni në institucion. Madje ka raste kur anëtarët e bordit të një institucioni kanë mandate me kohëzgjatje të ndryshme. Në shumë raste deri më tani, zëvendësimi i anëtarëve të bordeve me mandate të skaduar ose zgjatja e mandatit të tyre është zvarritur për shumë muaj. Kjo ka ardhur si pasojë e mos ekzistimit të një sistemi i cili monitoron mandatin e secilit anëtar të bordit. Andaj, me qëllim që anëtarët e komisionit të jenë të njoftuar për mandatet e anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura, stafi mbështetës nevojitet që të hartoj një dokument i cili përmban të dhëna specifike për secilin anëtar të bordit të institucionit të pavarur: data e emërimit si anëtar i bordit dhe data e përfundimit të mandatit. Në bazë të këtij dokumenti, zyrtarët e komisionit parlamentar duhet të informojnë anëtarët e komisionit për rastet kur afrohet përfundimi i mandatit të një apo më shumë anëtarëve të bordit (bordeve).

Edhe pse shpallja e konkursit, intervistimi dhe përzgjedhja e listës së ngushtë të kandidatëve për anëtar të bordeve është kompetencë e Qeverisë, komisioni parlamentar mund: ti dërgoj një shkresë Qeverisë së Kosovës nga e cila kërkon fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve të ri për anëtar të bordit (bordeve), ose të ftoj zyrtarët qeveritar që të raportojnë në komision për përgatitjet e tyre për të menaxhuar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të ri të bordit të një institucioni të pavarur. Në këtë mënyrë komisionet parlamentare do të jenë më të angazhuara në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve dhe në të njëjtën kohë do të shmangen praktikat e tejkalimit të mandatit ose mos funksionimit të bordeve si pasojë e anëtarëve me mandat të skaduar.

## *7.4 Përgjegjësitë e institucioneve të pavarura ndaj Kuvendit*

Kuvendi i Kosovës përveç që i themelon, aprovon buxhetin dhe bën përzgjedhjen e anëtarëve në pozitat udhëheqëse të institucioneve të pavarura, gjithashtu mbikëqyrë punën e tyre. Institucionet e pavarura janë të obliguara që të raportojnë para Kuvendit në baza të rregullta vjetore. Kuvendi e ka të drejtën të kërkojë raporte të jashtëzakonshme nga çdo institucion.

Afatet e dorëzimit të raporteve vjetore ndryshojnë nga institucioni në institucion dhe janë të përcaktuara në ligjet përkatëse. Por, zakonisht, institucionet e pavarura janë të obliguara që të dorëzojnë raportin vjetor të punës më së largu deri më 31 mars të vitit të ardhshëm fiskal. Të gjitha institucionet kanë së paku tre muaj kohë, nga data e përfundimit të vitit, që të përgatisin raportet e tyre vjetore. Përmbajtja e raporteve dallon në bazë të fushëveprimtarisë së institucionit. Nuk ekziston ligj apo akt nënligjor i veçantë i cili përcakton rregullat e hartimit të raporteve vjetore. Disa ligje parashohin edhe përmbajtjen bazë të raportit të cilin institucioni është i obliguar që ta dorëzojnë në Kuvend.

> Raporti i Bankës Qendrore*
>
> Brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar, Banka Qendrore do t'i dorëzojë zyrtarisht
> Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrit si dhe do të publikoj një apo më shumë raporte të aprovuara nga Bordi i Bankës Qendrore mbi gjendjen e ekonomisë gjatë vitit financiar të porsapërfunduar, duke përfshirë:
> - një parashikim mbi ekonominë e vitit në vijim,
> - arritjen e objektivave të politikave të saj dhe gjendjen e sistemit financiar të Kosovës.
> - një rishikim dhe vlerësim të politikave të Bankës Qendrore të ndjekura gjatë vitit financiar të kaluar, si dhe
> - një përshkrim dhe shpjegim të politikave për t'u ndjekur gjatë vitit financiar në vijim.
>
> * Ligji nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës, neni 28.2.

Raportet vjetore duhet të përmbajnë së paku këto elemente:

- Përmbledhje e shkurtër për misionin dhe fushëveprimtarinë e institucionit;
- Baza ligjore me të cilën operon;
- Struktura organizative e institucionit (bordet, departamentet, njësitë);
- Gjendja e përgjithshme e sektorit në të cilin agjencioni apo rregullatori operon;
- Buxheti me të cilin institucioni ka operuar dhe mënyra e shpenzimit të tij;
- Stafi i përgjithshëm i punonjësve, rekrutimet apo largimet nga puna gjatë vitit të fundit, niveli i pagave të stafit dhe përgatitja e tyre profesionale;
- Të gjitha aktivitetet e institucionit brenda vitit: shqyrtime të rasteve, aplikime për licenca, aprovime të kërkesave, pjesëmarrje në trajnime apo forume ndërkombëtare;
- Problemet me të cilat është ballafaquar institucioni gjatë vitit të fundit;
- Plani dhe resurset shtesë të cilat i nevojiten institucionit për të tejkaluar pengesat në punë;
- Të hyrat të cilat institucioni i ka gjeneruar (nëse është institucion i cili gjeneron të hyra);

Përmbajtja e raporteve të rregullta të institucioneve të pavarura mund të evoluojë me kohë, si rrjedhojë e kompetencave të reja të këtyre institucioneve, ose si rrjedhojë e rekomandimeve që komisionet parlamentare mund t'i japin institucionit për të plotësuar raportet e radhës. Komisionet parlamentare, përveç raporteve të rregullta, mund të kërkojnë edhe raporte të veçanta për një çështje të caktuar. Këtë e parashohin rregullat e punës së Kuvendit, por edhe ligje të veçanta të cilat rregullojnë fushëveprimtarinë e komisionit.

Raportet e veçanta mund të shërbejnë si pjesë e një mbikëqyrje më të gjerë të cilën komisioni funksional mund ta ndërmarrë për të mbikëqyrur më për së afërmi punën e një institucioni të pavarur, me ç'rast mund edhe të ndërmarrë vizita mbikëqyrëse, të organizojë dëgjime mbikëqyrëse, të marrë opinionet e shoqërisë civile dhe ekspertëve të pavarur. Procedurat për mbikëqyrje të institucioneve të pavarura janë të njëjta me mbikëqyrjen e ligjeve, buxhetit dhe strategjive.

Zyrtarët mbështetës të komisionit parlamentar, në fillim të çdo viti, duhet të përgatisin një kalendar, ku specifikojnë datat kur institucionet e pavarura janë të obliguara të raportojnë. Në rast të vonesave në dërgimin e raportit, stafi mbështetës duhet të ia kujtoj kryetarit dhe anëtarëve të komisionit se institucioni i caktuar nuk ka dorëzuar raportin periodik, ashtu siç është paraparë me kalendar të punës së komisionit dhe me ligj. Pasi që përpilimi i raportit dhe raportimi është obligim ligjor, komisioni parlamentar duhet të përgatis ankesë në drejtim të institucionit për mos dorëzimin e raportit apo paraqitjen për raportim.

# 8. Shtojcat

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

**Komisioni për ... [Emri i Komisionit]**

**Plani i veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ...**
**[Emri i ligjit që mbikëqyret]**

Data/muaji/viti
Vendi

Grupi punues, në bazë të vendimit të Komisionit për ... [Emri i Komisionit], të mbledhjes së datës ... [Shëno datën] përgatitë Planin e veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit ... [Emri i ligjit që mbikëqyret].

**Anëtarët e Grupit punues**

1. Emri dhe mbiemri, Kryesues
2. Emri dhe mbiemri
3. Emri dhe mbiemri
4. Emri dhe mbiemri
5. Emri dhe mbiemri

**Bashkëpunëtorët:**

1. Emri dhe mbiemri
2. Emri dhe mbiemri

**Stafi mbështetës i Komisionit:**

1. Emri dhe mbiemri, Koordinator
2. Emri dhe mbiemri, Zyrtar i Fushës
3. Emri dhe mbiemri, Zyrtar Ligjor

| Afatet kohore | Aktivitetet | Lokacioni/koha | Shënim | Personat përgjegjës |
|---|---|---|---|---|
| ***Faza e parë*** | | | | |
| **Java I**<br>(Data/muaji) | Përgatitja e planit të veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit ... | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Koordinatori i Komisionit e përgatit planin e veprimit në bashkëpunim me grupin punues, në bazë të të cilit zhvillohen të gjitha aktivitetet e mbikëqyrjes. | Grupi Punues<br>Koordinatori |
| | Identifikimi i obligimeve që parasheh Ligji për Qeverinë, institucionet publike dhe private | | Ky dokument do t'ju shërbej anëtarëve të grupit punues të fokusohen në çështjet apo dispozitat kryesore që duhet të mbikëqyren. | Koordinatori |
| | Vlerësimi i përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin | | Stafi mbështetës i Komisionit e përgatit një vlerësim lidhur me përputhshmërinë e akteve nënligjore të nxjerra nga Ministria me Ligjin për ... | Koordinatori |
| ***Faza e dytë*** | | | | |
| **Java II**<br>(Data/muaji) | Vizitë në Ministrinë e ...<br>∞ Sekretari i Ministrisë<br>∞ Zyra Ligjore e Ministrisë<br>∞ Departamenti ... | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Grupi punues i mbështetur nga stafi i Komsionit viziton Ministrinë e ... me qëllim të informimit lidhur me nivelin e zbatimit të Ligjit për ... | Grupi Punues<br>Koordinatori |
| **Java III** | Vizita në Komunat e Kosovës:<br>1. Komuna e ...: | Lokacioni<br>Dita/Data | Grupi punues vendos se cilat Komuna apo qytete do të vizitohen. Ndërkaq, stafi mbështetës i Komisionit aranzhon | Grupi Punues<br>Koordinatori |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| (Data/muaji) | ∞ Drejtorati për ...<br>∞ Drejtorati për ...<br>∞ Institucioni ... | Koha<br>Salla | takimet me subjektet e përcaktuara. | |
| **Java IV**<br><br>(Data/muaji) | 2. Komuna e Prishtinës<br>∞ Drejtorati për Shëndetësi<br>∞ Drejtorati për Inspekcion<br>∞ Një lokal afarist ose hotelier | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | | |
| | 3. Komuna e Mitrovicës<br>∞ Drejtorati për Shëndetësi<br>∞ Drejtorati për Inspekcion<br>∞ Një lokal afarist ose hotelier | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | | |
| | Vizita në 2 kompani private që merren me veprimtarinë e duhanit<br>∞ Kompani për prodhimin e duhanit ...<br>∞ Kompani për import të duhanit ... | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Grupi punues përzgjedh dy kompani që merren me prodhimin dhe importin e duhanit për t'i vizituar. | Grupi Punues<br>Koordinatori |
| | Vizitë në ... [Emri i institucionit apo vendit që do të vizitohet] | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Grupi punues i m bështetur nga stafi i Komsionit viziton ...m e qëllim të informimit lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit për ...q ë bien në kompetencë të këtij institucioni. | Grupi Punues<br>Koordinatori |

| ***Faza e tretë*** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Java V**<br><br>(Data/muaji) | Raportim i Ministrit të Shëndetësisë në Komision | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Me ftesë të Komisionit ftohet Ministri i … të raportoj për nivelin e zbatimit të Ligjit për … | Komisioni<br>Grupi Punues<br>Koordinatori |
| **Java VI**<br><br>(Data/muaji) | Dëgjim mbikëqyrës/legjislativ | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Komisioni i përkrahur nga stafi mbështetës i Komisionit dhe në bashkëpunim me … [organizatën mbështetëse] organizon një dëgjim mbikëqyrës/legjisltiv, ku do të ftohen të gjitha palët e interesuara për të ofruar dëshmitë e tyre lidhur me zbatimin e Ligjit për … | Grupi Punues<br>Koordinatori<br>Zyrtari i organizatës mbështetëse |
| **Java VII**<br><br>(Data/muaji) | Përgatitja e raportit me rekomandime | Zyra mbështetëse e Komisionit | Koordinatori i Komisionit në bashkëpunim me Grupin punues përgatisin raportin final me rekomandime të cilin e prezantojnë në Komision për shqyrtim dhe miratim. | Grupi Punues<br>Koordinatori |
| **Java VIII**<br><br>(Data/muaji) | Miratimi i raportit me rekomandime nga Komisioni | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Komisioni në mbledhje të rregullt e shqyrton dhe miraton raportin dhe i rekomandon Kryesisë që raporti të shqyrtohet në seancë plenare. | Komisioni |
| **Java IX**<br><br>(Data/muaji) | Shqyrtimi i raportit me rekomandime në seancë plenare | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Me rekomandim të Komisionit, Kryesia e Kuvendit e vendos si pikë të rendit të ditës për seancë plenare, shqyrtimin e raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për … Në seancë plenare në emër të Komisionit, raportin e prezanton Kryesuesi i grupit punues. | Kryesia e Kuvendit<br>Kryesuesi i Grupit punues |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***Faza e katërt*** | | | | |
| **Pas gjashtë (6) muajve**<br>(Data/muaji) | Raportim i Ministrit të ... në Komision lidhur me zbatimin e rekomandimeve të raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ..., të miratuar nga Kuvendi | Lokacioni<br>Dita/Data<br>Koha<br>Salla | Komisioni e fton M inistrin e . .. të raportoj p ër z batimin e rekomandimeve të raportit për mbikëqyrjen e Ligjit për ... të miratuar nga Kuvendi para 6 muajve. | Komisioni |

Data/muaji/viti

Vendi

Emri dhe mbiemri

Kryesuese e Grupit Punues

_______________

## Shtojca 2 – Identifikimi i obligimeve që parasheh Ligji për zbatuesit

| **Identifikimi i obligimeve që Ligji për ...** [Emri i ligjit] **parasheh për Qeverinë, institucionet publike dhe private dhe qytetarët (zbatuesit)** | | |
|---|---|---|
| **Ligji për ...** | **Ligji nr ... për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ...** | **Obligimet që parasheh Ligji për Qeverinë, institucionet publike dhe private dhe qytetarët** |
| ***Ky Ligj është shpallur nga …*** [institucioni që e ka shpallur] ***më…*** [Data/muaji/viti] ***dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare më …*** [Data/muaji/viti] | ***Ky Ligj është shpallur me Dekret nga Presidenti i Kosovës më ...*** [Data/muaji/viti] | |
| *[Në këtë kolonë vendosen dispozitat e ligjit në fuqi].*<br><br>Neni 1 … | *[Në këtë k olonë vendosen dispozitat e l igjit të ndryshuar dhe plosësuar (nëse është i tillë)].*<br><br>Neni 1 ... (Ndryshim dhe plotësim) | *[Në këtë kolonë vendosen dispozitat e ligjit të cilat paraqesin obligime për zbatuesit dhe të cilat do të mbikëqyren nga Komisioni].*<br><br>Çka parasheh neni?<br>Kush është përgjegjës për zbatimine tij?<br>Sa është duke u zbatuar? |
| Neni 2 … | Neni 2 ... (Ndryshim dhe plotësim) | Çka parasheh neni?<br>Kush është përgjegjës për zbatimine tij?<br>Sa është duke u zbatuar? |
| Neni ... | Neni ... | Pyetjet???<br><br>Vëretje: Varësisht nga dispozita ligjore bëhet edhe identifikimi i çështjeve për m bikëqyrje apo pyetjeve q ë do t'ju bëhen përgjegjësve për zbatimin e tyre. |

## VLERËSIMI I I PËRPUTHSHMËRISË SË AKTEVE NËNLIGJORE ME LIGJINP ËR …

**Lista e akteve nënligjore të nxjerra nga institucioni përgjegjës për zbatimin e Ligjit:**

1. Udhëzimi administrativ n r. xx/xx, për …
2. Udhëzimi administrativ n r. xx/xx, për …
3. Rregullorja për …
4. . . .

**Tabela për vlerësimin e përputhshmërisë**

| Dispozitat ligjore që parashohin akte nënligjore | Akti nënligjor | Vlerësimi i përputhjes së dispozitave të aktit nënligjor meL igjin |
|---|---|---|
| [Në këtë kolonë vendosen dispozitat e ligjit që parashohin nxjerrjen e akteve nënligjore].<br><br>Neni 1 … | Në këtë k olonë shënohet emërtimi i a ktit n ënligjor nëse është nxjerrë nga Institucioni përgjegjës.<br><br>Nëse nuk është nxjerrë atëherë specifikohet q ë institucioni përgjegjës nuk e ka n xjerrë aktin e papararë n ën l igjor në afatin e përcaktuar me ligj. | [Akti nënligjor analizohet n ë hollësi dhe vlerësohet nëse p ërputhet m e dispozitën l igjore a po n ëse tejkalon autorizimet nga dispozita ligjore].<br><br>[Për s ecilën akt nënligjor të a nalizuar m und të j ipet një vlerësim, vërejtje apo koment.] |
| Neni 2 … | | |
| Neni xx … | | |

## Shtojca 4: Pyetjet standarde për zbatuesit

Shënim: Model i pyetjeve të shfrytëzuara gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës me Komisionin për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë takimit me njërin nga ambasadorët e Kosovës në një shtet të BE-së.

Pyetjet për ambasadorin:

1. Sa po arrini t'i përmbushni detyrat dhe përgjegjësitë tuaja si ambasador? Sa po arrini ti mbroni interesat e Kosovës në vendin ku ju vepроni? Cilat janë qëndrimet e vendit nikoqir për Kosovën (në aspektin politik, ekonomik, social dhe kulturor)? Çfarë raporte zhvilloni me ambasadat tjera që veprojnë në atë shtet (përparësitë dhe mangësitë)?

2. Cilat janë format dhe koha e raportimit tek Ministria e Punëve të Jashtme?

3. Si funksionon ambasada ku jeni ambasador? Cili është lokacioni i ambasadës? Sa personel keni në ambasadë? Sa jeni të kënaqur me përformancën e tyre? A keni staf të mjaftueshëm?

4. Ministria ka paraparë nxjerrjen e akteve nënligjore me të cilat rregullon rangjet diplomatike të Shërbimeve Diplomatike të Kosovës. Neni 8, paragrafi 2. thotë që: "Rangjet diplomatike në përdorim ndërkombëtar të anëtarëve të Shërbimit Diplomatik të Kosovës përveç shefave të misioneve do të rregullohen me akte nënligjore të Ministrisë." Si i keni të rregulluara rangjet diplomatike në Ambasadën ku ju jeni ambasador? A janë në përputhje me Ligjin dhe aktet tjera? Dhe, a mendoni që i plotësojnë standardet e duhura dhe nevojat e ambasadës rangimi aktual?

5. Cili është buxheti vjetor i ambasadës? Si jeni duke menaxhuar me buxhetin? Ministria e Jashtme dhe Ministria e Financave a kanë nxjerr legjislacionin e duhur për menaxhim të buxhetit, e cila parashihet me nenin 9 të Ligjit? A keni pasur auditim nga ndonjë institucion i Republikës së Kosovës apo Auditor i jashtëm (privat)?

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

**PËR:** **Deputetët e Kuvendit**
**Cc:** **Kryesinë e Kuvendit**
**Nga:** **Komisioni për....[Shëno emrin e komisionit]**
**Lënda:** **Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për....[Shëno emërtimin e ligjit]**
**Nr.:** ______________
**Data:** **Data/Muaji/Viti**

---

Komisioni për...[Shëno emrin e komisionit], në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, bëri mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ...
[Shëno emërtimin e ligjit].

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më ... [Data/muaji/viti], vendosi që Kuvendit t'i paraqes këtë:

**Rekomandim**

I. I rekomandohet Kuvendit që t'i miratojë rekomandimet, si në vijim:

1. ........ Rekomandimi 1
2.......... Rekomandimi 2
3.......... Rekomandimi 3

II. Arsyetimin lidhur me këtë raport e paraqet deputeti ______________________, kryetar /zëvendëskryetar/ raportues i Komisionit.

Bashkëngjitur: Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit...
[Shëno emërtimin e ligjit].

Kryetari i Komisionit

______________
[Emri dhe mbiemri]

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

Legjislatura e IV-të
Sesioni pranveror

**Komisioni për ...[Shëno emrin e Komisionit]**

# Raport

**Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.... për...**

**Prishtinë,.......... 2012**

## PËRMBAJTJA

*Tabela e shkurtesave*

**1. Hyrje**

**2. Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për ... [Shëno emrin e ligjit]**

**3. Përbërja e grupit punues**

1. Emri dhe mbiemri, Raportues
2. Emri dhe mbiemri, anëtar
3. Emri dhe mbiemri, anëtar
4. Emri dhe mbiemri, anëtar
5. Emri dhe mbiemri, anëtar

**4. Aktivitetet e Grupit Punues në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit**

a. Takimet e Grupit Punues
b. Vizitat në terren
c. Organizimi i dëgjimit mbikëqyrës
d. Raportimi i përgjegjësve për zbatimin e ligjit në Komision
e. Raportimet në mbledhjet e Komisionit

**5. Zbatueshmëria e Ligjit për ... [Shëno emrin e ligjit]**

a. Problemet e identifikuara në zbatimin e ligjit duke u bazuar në informacionet e kërkuara nenin 73 të Rregullores së Kuvendit dhe problemet kryesore të implementimit.
b. Konkluzion

**6. Përgjegjësia e Qeverisë**

(A i ka përmbushur ministria përkatëse detyrat para komisionit, të parapara më nenin 73 të Rregullores së Kuvendit)

**7. Materiale përcjellëse**

a. Dokumentet nga Komisioni për ... [Shëno emrin e Komisionit]
b. Raportet nga vizitat në terren
c. Dokumente të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit

Prishtinë, më.......

## Shtojca 5: Institucionet e pavarura

| Nr. | Institucioni | Ligji i cili rregullon fushëveprimtarinë e institucionit | Anëtarësia e Bordeve Drejtuese dhe mandati i tyre | Raportimi para Kuvendit dhe Afatet Kohore | Komisioni Mbikëqyrës |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Avokati i Popullit** | Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit | Gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të Avokatit të Popullit dhe 5 zëvendësve të tij, komisioni përgjegjës informon Kuvendin dhe fillon procedurat për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit.<br><br>Sami Kurteshi është zgjedhur Avokat i Popullit nga Kuvendi i Kosovës më **4 qershor 2009**; z.Kurteshi nuk ka të drejtë rizgjedhjeje.<br><br>Më **4 dhjetor 2013**, Kuvendi duhet të filloj procedurat për përzgjedhjen e Avokatit të popullit dhe 5 zëvendësve të tij.<br><br>Para datës **4 qershor 2014**, Kuvendi zgjedh Avokatin e ri të Popullit dhe 5 zëvendësit e tij. | Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor deri më **31 mars** të vitit vijues. Avokati i Popullit e paraqet raportin në seancë plenare.<br><br>Avokati i Popullit ka të drejtë t'i paraqesë raport të veçantë Kuvendit, duke i propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur. | Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione |
| 2 | **Zyra e Auditorit të Përgjithshëm** | Ligji nr. 03 / L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës | Kuvendi e emëron Auditorin e Përgjithshëm me mandat për pesë (5) vite.<br><br>Kurëdo që pozita e auditorit të përgjithshëm mbetet vakante, Kuvendi në afat prej 60 ditësh e plotëson atë.<br><br>(Deri në përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare, Auditorin e Përgjithshëm e emëron PCN. Auditori aktual ka mandat deri më 2013. Pas kësaj, i mbetet Kuvendit të zgjedh Auditorin e Përgjithshëm. Ligji aktual nuk parasheh procedurat se si përzgjidhet Auditori i Përgjithshëm. Ligji për Auditorin e Përgjithshëm duhet të ndryshohet dhe procedurat e përzgjedhjes së Auditorit të Përgjithshëm të jenë të njëjta me ato sikurse për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit apo Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsion). | Një herë në vit, brenda afatit prej tre **(3) muajve pas përfundimit të vitit** të llogarisë, auditori i përgjithëm i dërgon Kuvendit një raport vjetor mbi auditimin e bërë nga ana e tij. Ky raport duhet të përmbajë edhe një raport mbi auditimin e pavarur të llogarive të Zyrës së Auditimit të Kosovës.<br><br>Auditori i përgjithshëm i siguron një raport Kuvendit mbi auditimin e rregullsisë së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të çdo institucioni apo subjekti tjetër jo më vonë se deri më **31 gusht** të vitit pas periudhës së | Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kontrollit. | |
| 3 | **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** | Ligji Nr. 03/L – 073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë | KQZ përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë: nga Kryesuesi dhe dhjetë (10) anëtarë të tjerë.<br>Kryesuesi, emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe zgjidhet mes gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.<br><br>Mandati i Kryetarit të KQZ-së është shtatë (7) vjet duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.<br>Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben në më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme. | KQZ-ja i përgatit Kuvendit të Kosovës një raport vjetor dhe atë në muajin prill. Raporti përmban informata lidhur me aktivitetet e KQZ-së dhe rekomandimet që KQZ-ja i sheh si të përshtatshme që të trajtohen në Kuvend. | Komisioni për Legjilsacion |
| 4 | **Banka Qendrore e Kosovës** | Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës | Organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore janë: Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori.<br>Bordi i Bankës Qendrore do të përbëhet nga Guvernatori, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit dhe tre (3) anëtarë joekzekutivë.<br>Bordi Ekzekutiv përbëhet nga guvernatori dhe nga Zëvendës-guvernatorët.<br><br>Guvernatori dhe anëtarët jo-ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore emërohen për një mandat prej pesë (5) vitesh. | Të paktën **një herë në vit**, si dhe varësisht prej nevojës edhe më shpesh, Banka Qendrore do të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe publikun në lidhje me realizimin e politikave të saj, arritjet e objektivave të saj, si dhe këndvështrimet e saj në lidhje me treguesit real të ekonomisë.<br><br>**Brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar**, Banka Qendrore do t'i dorëzojë zyrtarisht Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrit si dhe do të publikoj një apo më shumë raporte të aprovuara nga Bordi i Bankës Qendrore mbi gjendjen e ekonomisë gjatë vitit financiar të porsapërfunduar, duke përfshirë një parashikim mbi ekonominë e vitit në vijim, arritjen e objektivave të politikave të saj dhe gjendjen e sistemit financiar të Kosovës. Raporti duhet gjithashtu të përmbajnë një rishikim dhe vlerësim të politikave të Bankës Qendrore të ndjekura gjatë vitit financiar të kaluar, si dhe një përshkrim dhe shpjegim të | Komisioni për Buxhet dhe Financa |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | politikave për t'u ndjekur gjatë vitit financiar në vijim.<br><br>Guvernatori me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës ose me nismën e vet, **së paku një herë në vit**, dëgjohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe nga komisionet e tij për objektivat e Bankës Qendrore. | |
| 5 | **Komisioni i Pavarur i Mediave** | Ligji Nr. 04/ L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave | KPM përbëhet nga 7 anëtarë. Së paku dy (2) anëtarë të KPM-së emërohen nga radhët e komuniteteve joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.<br><br>**Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së**<br>Anëtarët e KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente.<br><br>Kandidatët për anëtarë të KPM-së zgjedhen sipas procedurave të mëposhtme:<br>– brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj;<br>– kandidaturat e pranuara shqyrtohen nga një Komision ad –hoc i Kuvendit të Kosovës;<br>– brenda periudhës kohore prej njëzetenjë (21) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni ad-hoc, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë të anëtarit të KPM-së, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, përgatitjes profesionale integritetit dhe përkushtimit të tyre për fushëveprimin e KPM-së;<br>– Bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm | KPM i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars te vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. | Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | dhe që votojnë.<br><br>**Mandati i Anëtarëve të KPM-së** 1.<br><br>Mandati i anëtarëve të KPM-së do të jetë si në vijim:<br>– dy (2) anëtarë të KPM-së do të emërohen me mandat dy (2) vjeçar,<br>– tre (3) anëtarë me mandat tre (3) vjeçar dhe<br>– dy (2) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar.<br><br>Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve bëhet me short.<br><br>Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të KPM-së është dy (2) vite dhe me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat. | | |
| 6 | **Agjencia Kundër Korrupsionit** | Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit | Kuvendi zgjedh Drejtorin e AKK për një mandat 5 vjeçar;<br><br>Drejtoiri aktual i Agjencisë është zgjedhur më 23.9.2011.<br><br>Mandati i drejtorit aktual skadon më 23.9.2016.<br><br>Gjashtë muaj para skadimit të mandatit (mars 2016), komisioni mbikëqyrës informon Kuvendin, me qëllim të fillimit të procedurave për përzgjedhjene drejtorit.<br><br>Hasan Preteni, drejtori aktual i AKK, është zgjedhur për mandat të dytë dhe nuk ka të drejtë rizgjedhjeje. | Agjencia paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak , më së largu deri më **31 mars** të çdo viti kalendarik.<br><br>Agjancia raporton çdo 6 muaj para komisionit mbikëqyrës. Ligji nuk e specifikon afatin kohor se në çfarë kohe AKK duhet të paraqes raport para komisionit. Mirëpo, sipas rregullit, raporti i parë duhet të jetë në pjesën e parë të vitit, kurse raporti i dytë në gjashtëmujorin e dytë.<br><br>Komisioni mund të kërkoj raporte më të shpeshta nga agjencia, në çdo kohë që komisioni mbikëqyrës e sheh të nevojshme. | Komisioni për Legjislacion |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Agjencia, përmes Qeverisë, paraqet në Kuvend për miratim Strategjinë dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit<br><br>Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2012-2016 është aprovuar në Qeveri (11.1.2012) dhe pas shqyrtimit nuk është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. | |
| 7 | **Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik** | Ligji nr. 04/L-042 për prokurim publik në Republikën e Kosovës | KRPP-ja përbëhet prej tre (3) anëtarëve. Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat prej pesë (5) vjetësh, dhe mund të riemërohen vetëm një herë.<br><br>Kryetari dhe anëtarët e KRPP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi. Gjatë propozimit të personave në fjalë, Qeveria duhet të respektoj kërkesat për anëtarësim, të specifikuara në paragrafin 3. dhe 4. të këtij neni.<br><br>Asnjë person nuk mund të propozohet, emërohet ose të shërbejë si anëtar i KRPP-së nëse ai/ajo nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit për ndonjë arsye të ndonjë dispozite të listuar në paragrafin 3. të nenit 65 të këtij ligji. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojë që asnjë person i tillë të mos propozohet ose emërohet për anëtar në KRPP. | KRPP për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Shkurtit të vitit vijues kalendarik; | Komisioni për Buxhet dhe Financa |
| 8 | **Organi Shqyrtues i Prokurimit** | Ligji nr. 04/L-042 për prokurim publik në Republikën e Kosovës | OSHP-ja përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Bordit, që emërohen për një mandat pesë (5) vjeçar dhe mund të riemërohen vetëm një herë. Për mbështetje administrative OSHP-së i ndihmon Sekretariati i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit.<br><br>Anëtarët e OSHP-së të cilët ishin emëruar nën miratimin e mëhershëm do të mbajnë mandatin deri në skadimin e atij emërimi, dhe mund të ri-zgjedhën vetëm nëse ata kanë qenë të kualifikuar për ri-emërim nën ligjin aktual në kohën kur ata ishin emëruar. Me mbarimin e mandatit fillestar çdo | OSHP-ja, duke vepruar përmes Kryetarit, duhet të sigurojnë një raport vjetor me shkrim për Kuvendin e Republikës Kosovës, jo më vonë se deri në **fund të muajit shkurt**, në lidhje me vitin paraprak financiar me informacionet vijuese sipas aktiviteteve të prokurimit dhe llojit, duke bërë dallimin në mes të ankesave të autoriteteve kontraktuese nga vendimet e APP-së/KRPP-së dhe ankesave nga tenderuesit. | Komisioni për Buxhet dhe Financa |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | riemërim ose emërim i ri bëhet për një mandat pesë (5) vjeçar.<br><br>Kryetari dhe anëtarët e OSHP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi në bazë të rekomandimit që është marrë nga një organ përzgjedhës i pavarur i themeluar nga Kuvendi.<br><br>Kuvendi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe emëron personat e përzgjedhur | | |
| 9 | **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** | Ligji nr. 03/ L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës | Këshilli Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar.<br><br>Këshilli Gjyqësor i Kososvës, nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryesuesin dhe Zëvendës kryesuesin me mandat trevjeçar. | KGJK paraqitet, së paku një herë në vit, para Kuvendit të Kosovës dhe raporton mbi performancën, veprimet, shpenzimet dhe nevojat e gjyqësorit të Kosovës. | Komisioni për Legjislacion |
| 10 | **Agjencia Kosovare e Privatizimit** | Ligji Nr. 2011/04-L-034 për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës | Agjencia ka Bordin e Drejtorëve, Drejtorin Menaxhues dhe dy Zëvendësdrejtorë Menaxhues, Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive si dhe personelin profesional dhe teknik.<br><br>Kompetencat e AKP-së i janë dhënë Bordit të Drejtorëve, i përbërë nga tre drejtorë ndërkombëtarë dhe pesë Kosovarë. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.<br><br>Kryesuesi, Zëvendëskryesuesi dhe Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive tëe Bordit emërohen për një mandat tre (3) vjeçar dhe tëe tjerët për një mandat dy (2) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. | Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe e bën publik raportin vjetor të Agjencisë. | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |
| 11 | **Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale** | Ligji Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Mineralet | KPMM drejtohet nga Bordi (“Bordi i KPMM”) i cili përbëhet prej pesë (5) anëtarëve.<br><br>Mandati i anëtarëve fillestar të Bordit të KPMM të emëruar në përputhje me këtë ligj është si vijon: një anëtar ka mandat 4 vjeçar, dy anëtarë kanë mandat | Brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga përfundimi i çdo viti kalendarik, KPMM do të përgatisë, publikojë në faqen zyrtare dhe dorëzojë Kuvendit një raportin vjetor. | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | tre (3) vjeçar, dhe dy (2) anëtarë kanë mandat dy (2) vjeçar. Mandatet e të gjithë pasardhësve të anëtarëve fillestar janë katër (4) vjet. Asnjë person nuk mund të shërbejë në Bordin e KPMM më shumë se dy (2) mandate. | | |
| 12 | **Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës** | Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil | Veprimtaria e AAC-së mbikëqyret nga një Bord Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga pesë anëtarë Anëtarët e parë të Bordit do të kenë këto mandate: (i) Kryesuesi i parë dhe një anëtar tjetër i parë kanë mandat dy vjeçar; dhe (ii) tre anëtarët e tjerë të parë kanë mandat katër vjeçar. | Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Drejtori i Përgjithshëm duhet të përgatisë, përfundojë dhe sigurojë Bordit, Ministrisë, Qeverisë dhe Kuvendit, një raport gjithëpërfshirës vjetor i cili siguron informata të hollësishme për vitin e shkuar kalendarik. | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |
| 13 | **Zyra e Rregullatorit për Energji** | Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë | Zyra e Rregullatorit për Energji drejtohet nga Bordi i përbërë nga pesë (5) anëtarë, përfshirë kryesuesin.<br><br>Mandati i anëtarëve të parë të Bordit është:<br>a) 2 vjet për kryesuesin;<br>b) 2 vjet për një anëtar;<br>c) 3 vjet për një anëtar.<br>ç) 4 vjet për një anëtar;<br>d) 5 vjet për një anëtar.<br><br>Mandati i anëtarëve të ardhshëm do të jetë nga pesë vite.<br><br>Çdo anëtar i Bordit, përfshirë edhe anëtarët e parë, mund të riemërohen edhe për një mandat tjetër pesë vjeçcar. | Kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit për Energji i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës çdo vit raportin vjetor, jo më vonë se tre (3) muaj pas mbylljes së vitit kalendarik. | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |
| 14 | **Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit** | Ligji Nr. 03 / L-85 për Telekomunikacionin | Autoritet ligjor i ART-së është Bbordi i ART-së. Bordi përbëhet nga (5) pesë anëtarë.<br>Secili anëtar i bordit rregullator do të shërbejë me një mandat prej 5 vitesh nga data eemërimit të tij. Numri i emërimeve për një anëtar do të jetë vetëem dy mandate. Për t'u siguruar që mandatët e jo më shumë se 2 anëtarëve të skadojnë brenda një viti kalendarik, mandatët e anëtarëve fillestarë mund të | Jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së secilit vit fiskal, ART-ja i do të përregatisë dhe do t'i dorëzojë Kuvendit një raport vjetor që përmban detaje financiare, që i përkasin aktiviteteve të ART-sëit për vitin paraprak. | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | shtyhen. | | |
| 15 | **Instituti Gjyqësor i Kosovës** | Ligji Nr. 02/L-25 për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës | Organet e IGJK-së janë: Këshilli drejtues dhe Ddrejtori i IGJK-së. Këshilli drejtues përbëhet prej 13 (trembëdhjetë) anëtarëve. 9 (Nëntë) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Kosovës.<br><br>Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjedhën me mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje, por jo më shume se 2 (dy) mandate.<br><br>Drejtorin e IGJHK-së e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli Ddrejtues. | | Komisini për Legjislacion |
| 16 | **Autoriteti i Pavarur Rregullativ i Hekurudhave** | Ligji Nr. 03/L-076 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës | Të gjitha kompetencat e Autoritetit i ka Bordi, i cili përbëhet nga katër (4) anëtarë, ky bord përfshinë edhe kryesuesin, zëvendëskryesuesin dhe drejtorin e përgjithshëm.<br><br>Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat së paku trevjeçar (3), por jo më shumë se pesë (5) vjet. Anëtarët e Bordit mund të emërohen për më shumë se një (1) mandat. | Autoriteti Rregullator i Hekurudhave:<br>– mbikëqyrë dhe do t'i ofrojë informacione Kuvendit dhe Ministrisë së Transportit dhe Komunikacionit lidhur me zhvillimet në sektorin hekurudhor, çështjeve të ngjashme mbi sigurinë dhe kushtet e tregut për hekurudhat në Kosovë, me synim të paraqitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve hekurudhorë dhe<br>– bëjë rekomandime drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë lidhur me zhvillimet në sektorin hekurudhor, duke përfshirë edhe legjislacionin për të promovuar konkurrencë të drejtë dhe jodiskriminuese dhe t'i sigurojë Kuvendit e Ministrisë të gjitha informacionet relevante dhe të nevojshme për vlerësimin e rekomandimeve të tilla. | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |
| 17 | **Agjencia e Kosovës për Intelegjencë** | Ligji Nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Intelegjencë | Drejtori i AKI-sëw është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të AKI-së.<br><br>Drejtori i AKI-së emërohet për një mandat pesë (5) vjeçar, i cili mund tië vazhdohet edhe njëherë. | Drejtori i AKI-së raporton para Komisionit parlamentar mbikëqyrës sipas kërkesës. | Komisioni për mbikëqyrjen e punës së AKI-ut |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 18 | **Këshilli për Ndihmë Juridike Falas** | Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas | Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nga radhët e kandidatëve të propozuar nga institucionet e mëposhtme:<br>– Ministria e Drejtësisë;<br>– Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;<br>– Ministria për Kthim dhe Komunitete;<br>– Ministria e Financave;<br>– Oda e Avokatëve të Kosovës;<br>– Gjykata Supreme;<br>– Këshilli, bënë ftesë publike për anëtarët e OJQ-ve, ku nga të gjithë kandidatët i përzgjedh tre (3) prej tyre, të cilët i propozon para Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhje.<br><br>Inicimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga institucionet relevante e bënë Këshilli me kërkesë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit.<br><br>Institucionet relevante i përgjigjen Këshillit me listën e kandidatëve të propozuar në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të kërkesës së Këshillit.<br><br>Këshilli ia dërgon listën me emrat e propozuar, komisionit përkatës të Kuvendit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të listës së të propozuarve. | Këshilli i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës një herë në vit për punën e Agjencisë dhe publikon Raportin në faqen zyrtare të Agjencionit. | Komisioni për Legjislacion |
| 19 | **Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina** | Ligji Nr. 03/L-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësitë, Kanalizimit dhe të Mbeturinave | Drejtori dhe zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi i Kosovës pas rekomandimit të Qeverisë për një afat pesë (5) vjeçar. | | Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor |
| 20 | **Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës** | Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës | Bordi Drejtues e udhëheq Fondin dhe përbëhet prej tetë (8) anëtarëve, njëri prej të cilëve nuk ka të drejtë vote. | Nga Fondi kërkohet që informacionin e mëposhtëm t'ia paraqesë Kuvendit, BQK-së dhe një kopje Qeverisë: | Komisioni për Buxhet dhe Financa |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Një komision për përzgjedhje, i propozon kandidatët Kuvendit për vendet e lira në anëtarësim ose për riemërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni për Përzgjedhje do të përbëhet nga Guvernatori i BQK-së - kryesues, Auditori i Përgjithshëm dhe Ministri i Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në Bordin Drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes, nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është emëruar, atëherë anëtarët e Bordit ekzistues do të vazhdojnë mandatin për nëntëdhjetë (90) ditë. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do ta emërojë një përfaqësues me të drejtë vote, si anëtar të Bordit Drejtues, që përmbush kriteret e përcaktuara në paragrafin 4.4 të këtij neni dhe do të shërbejë njëkohësisht për aq kohë sa mbetet Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në Kosovë. Pas largimit të anëtarit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, Komisioni për Përzgjedhje duhet të plotësojë këtë pozicion.<br><br>Kuvendi emëron anëtarin (ët) e bordit drejtues, duke përfshirë edhe kryesuesin, bazuar në rekomandimet e komisionit për përzgjedhje, pas konsultimit me Qeverinë. Qeveria i'a dorëzon opinionin e saj Kuvendit brenda pesëmbdhetë (15) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së Kuvendit për konsultim. | – raportet e audituara të llogarive vjetore të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurat dhe shpenzimet;<br>– raportet tremujore, duke përfshirë hollësitë për shitjen dhe fitimin e mjeteve pensionale së bashku me identitetin e mjeteve, datën e transaksionit, çmimin me të cilin është bërë transaksioni dhe ndërmjetësi i cili është shfrytëzuar;<br>– raportet vjetore për vlerën dhe proporcionin e mjeteve pensionale të cilat janë investuar në klasa të veçanta të mjeteve, duke përfshirë hollësitë e dhënësve të letrave të veçanta me vlerë nga data e vlerësimit të fundit të muajit të fundit të çdo periudhe vjetore:<br>– raportet vjetore për të gjitha tarifat, si p.sh. pagesat e mbajtjes dhe pagesat tjera për shërbimet dhe transaksionet financiare;<br>– çështje të tjera të cilat mund të caktohen përmes rregulloreve që duhet të nxirren nga BQK-ja. | |
| 21 | **Komisioni i Konkurrencës** | Ligji Nr. 2004/36 për Konkurencën | KKK-ja përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Mandati i pesë anëtarëve të parë të KKK-së është si vijon: një anëtar emërohet për një një (1) vit, dy anëtarë emërohen për tri (3) vite dhe dy anëtarë të tjerë emërohen për pesë (5) vite. Pasardhësit e tyre emërohen për mandat prej pesë (5) viteve. | Për çdo vit kalendarik, do të përgatisë, publikoj dhe dorëzoj Kuvendit një raport vjetor duke i analizuar kushtet konkurruese në ekonominë e përgjithshme të Kosovës si dhe në sektorë të veçantë, industri dhe tregje, dhe duke i përmbledhur të gjitha masat hetimore dhe të ekzekutimit që KKK-ja i ka ndërmarrë gjatë vitit kalendarik në fjalë.<br><br>Raporti i tillë vjetor duhet të publikohet dhe ti dorëzohet Kuvendit deri në fund | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të Shkurtit të çdo viti pasues kalendarik. | |
| 22 | **Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës** | Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës itëShërbimit Civil të Kosovës | Këshilli përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen përmes konkursit të hapur dhe transparent tëe cil ët t emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit. Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar me mundësi rizgjedhje për edhe një mandat.<br><br>Përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtar emërohen nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar të jenë të gjinisë femërore.<br><br>Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Këshillit apo pas shpalljes së vendit të lirë të punës për arsye të tjera, Kuvendi i Kosovës në pajtim me rregulloren e punës nxjerrë shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj.<br><br>Emërimet e propozuara që pranohen shqyrtohen nga një Komision ad –hoc i Kuvendit të Kosovës.<br><br>Brenda periudhës kohore prej njëzetenjë (21) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo vend të lirë të punës në Këshillë, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e Shërbimit Civil politikisht të paanshëm | Këshilli i paraqet raport vjetor Kuvendit të Kosovës. Këshilli një kopje te raportit për informim ia përcjell Kryeministrit.<br><br>Raporti i Këshillit i vihet në dispozicion publikut pas aprovimit nga Kuvendi. Raporti botohet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës. | Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sporte, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat pesë (5) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat tjetër. | | |
| 23 | **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** | Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror emërohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Qeverisë së Kosovës për një periudhë pesë (5) vjeçare me mundësi të emërimit edhe për një mandat shtesë. | Agjencia duhet t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës raport vjetorë të punës dhe duhet ta publikojë atë, jo më vonë se më 31 mars, të vitit vijues. | Komisioni për Siguri dhe Punë të Brendshme dhe FSK |
| 24 | **Radio Televizioni i Kosovës** | Ligji Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës | Organi drejtues i RTK-së do të jetë Bordi i RTK-së, i përbërë prej 9 anëtarëve të cilët janë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës.<br><br>Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit të RTK-së është dy vite, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat,<br><br>Mandati i anëtarëve të Bordit do të jetë tri vjet.<br><br>Një komision special ad-hoc i Kuvendit i përbërë nga një përfaqësues i secilit subjekt politik i përfaqësuar në Kuvend do<br>të zgjedh me shumicë të thjeshtë njërin prej dy kandidatëve për secilën pozitë, emërimet e të cilëve për anëtarë të Bordit do të konfirmohen me akt pro forma të të gjithë Kuvendit. | RTK i raporton Kuvendit në bazë periodike dhe vjetore për llogarinë financiare në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike. | Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sporte, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media |

## Shtojca 7: Afatet kohore, detyrimet e Qeverisë dhe Kuvendit në procesin buxhetor

| Afatet kohore | Qeveria | Kuvendi |
|---|---|---|
| JANAR | Brenda tridhjetë (30) ditëve pas miratimit nga Kuvendi të Buxhetit vjetor të Kosovës dhe ligjit vjetor mbi ndarjet buxhetore, Ministri do përgatisë dhe publikojë në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në faqen ne internet të Ministrisë buxhetin si dhe dokumentet e tjera shpjeguese në formë gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme nga publiku, në gjuhët zyrtare që përdoren për dokumentet e Qeverisë. | Dy mujori i parë i secilit vit fiskal nuk paraqet ndonjë obligim të Kuvendit lidhur me shqyrtim apo miratim të buxhetit, përveç në rastet kur Kuvendi ka dështuar të aprovoj ligjin për ndarjet buxhetore para datës 31 dhjetor.<br><br>Gjatë kësaj periudhe, komisionet parlamentare hartojnë planet e tyre vjetore të punës, ku përfshijnë shqyrtimin e projektligjeve, mbikëqyrjen e ligjeve dhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së buxhetit nga ana e ministrive dhe institucioneve të pavarura. |
| MARS | Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Ministri do të përgatitë dhe dorëzojë Qeverisë, për miratim dhe dorëzim në Kuvend, një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet parapprake fiskale. | Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrton raportin tremujor dhe e referon atë për diskutim në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.<br><br>Komisionet parlamentare mund të diskutojnë për buxhetin e institucioneve që ato mbulojnë dhe të dalin me rekomandime në seancën plenare, kur diskutohet raporti tremujor i buxhetit. |
| PRILL | Jo më vonë se deri më 30 prill, Qeveria i dorëzon Kuvendit raportin e parë tre mujor për performancën buxhetore gjatë muajve janar-mars. | Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrton raportin vjetor të buxhetit dhe e referon atë për diskutim në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.<br><br>Komisionet parlamentare mund të diskutojnë për buxhetin e institucioneve që ato mbulojnë dhe të dalin me rekomandime në seancën plenare, kur diskutohet raporti përfundimtar i buxhetit. |
| | Jo më vonë se deri me 30 prill, Qeveria duhet t'ia dorëzojë Kuvendit Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve (KAMSH) për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale ("Periudha Buxhetore e KAMSH"). | Kuvendi shqyrton KAMSH. Ligji nuk përcakton ndonjë afat kohor se brenda cilës periudhë kohore Kuvendi duhet ta shqyrtoj dhe aprovoj KAMSH. |

| | | |
|---|---|---|
| | Ministri duhet të nxjerrë qarkoren(t) buxhetore të paraparë me paragrafin 2 të këtij neni, deri me 30 Prill të vitit aktual fiskal. | |
| **KORRIK** | Jo më vonë se deri më 30 korrik, Qeveria i dorëzon Kuvendit raportin e dytë tre mujor të performancës buxhetore për periudhën janar-qershor. | Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrton raportin gjashtëmujor dhe e referon atë për diskutim në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.<br><br>Komisionet parlamentare mund të diskutojnë për buxhetin e institucioneve që ato mbulojnë dhe të dalin me rekomandime në seancën plenare, kur diskutohet raporti gjashtëmujor i buxhetit. |
| **SHTATOR** | Data në të cilën komunat duhet t'i përfundojnë dhe dorëzojnë propozimbuxhetet dhe kërkesat e tyre për ndarje buxhetore është 30 Shtatori i atij viti. Për organizatat buxhetore të cilat nuk janë komuna, afati i fundit kohor për dorëzimin e këtyre dokumente është afati i përcaktuar në qarkoren buxhetore. | |
| **TETOR** | Jo më vonë se deri më 30 tetor, Qeveria i dorëzon Kuvendit raportin e tretë tre mujor të performancës buxhetore për periudhën janar-shtator. | Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrton raportin nëntëmujor dhe e referon atë për diskutim në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.<br><br>Komisionet parlamentare mund të diskutojnë për buxhetin e institucioneve që ato mbulojnë dhe të dalin me rekomandime në seancën plenare, kur diskutohet raporti nëntëmujor i buxhetit. |
| | Pas miratimit të propozim Buxhetit të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore, Qeveria ia dorëzon këto dokumente Kuvendit jo më vonë se më 31 tetor të atij viti fiskal. | Kuvendi ka dy muaj kohë që të shqyrtoj dhe aprovoj projektbuxhetin për vitin e ardhshëm fiskal.<br><br>Në rast se Kuvendi nuk arrin të aprovoj Ligjin e Buxhetit para datës 31 dhjetor, atëherë Kuvendi duhet të marr vendim për zgjatjen e zbatueshmërisë së ligjit të vitit të kaluar fiskal, por jo më shumë se tre muaj. |

**Shtojca8 : Strategjitë dhe Planet e Veprimit të miratuara ndër vite, zbatueshmëria e të cilave shtrihet edhe në 2012 dhe vitet në vazhdim**

| Nr. | Emërtimi | Miratimi | | Ministria përgjegjëse | Komisioni funksional |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Qeveri | Kuvend | | |
| 1 | Plani Strategjik për Akomodimin Rezidencial për Qeverinë e Kosovës | 27.2.2008 | - | Ministria e Administratës Publike (MAP) | Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Diasporë, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media (*Shkurt: Komisioni për Arsim*). |
| 2 | Strategjia për Qeverisjes Elektronike 2009-2015 | 12.12.2008 | - | MAP | Komisioni për Arsim |
| 3 | Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009 –2 015 dhe Plani i Veprimit | 24.12.2008<br>(Plani i veprimit është aprovu më 23.12.'09) | - | Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) | Komisioni për të Drejtat, Interesat dhe Kthim të Komuniteteve (*shkurt: Komisioni për Komunitete*) |
| 4 | Strategjia Afatmesme e Punës së MAPL 2009-20123 | 0.1.2009 | - | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) | Komisioni për Arsim |
| 5 | Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit për këtë strategji | 08.4.2009 | - | MPB<br>Ministria e Financave (MF)<br>Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës (AVUK) | Komisioni për Siguri<br>Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale |
| 6 | Strategjia dhe Plani Nacional i Veprimet për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009 – 2013 | 19.6.2009 | - | Zyra e Kryeministrit (ZK) | Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione |
| 7 | Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizimit dhe Plani i Veprimit | 19.6.2009 | - | MPB, MF, Agjencia e Kosovës për Intelegjencë (AIK) | Komisioni për Siguri |
| 8 | Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Drogave dhe Plani i | 19.6.2009- | | MPB, MF, Ministria e Shëndetësisë | Komisioni për Siguri |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Veprimit | | | (MSH), AIK | Komisioni për Shëndetësi |
| 9 | Strategjia Zhvillimore e Agjencisë Kadastrale të Kosovës 2009 – 2011 dhe Plani i Biznesit për Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Sektorin Kadastral në Kosovë 2009 – 2014 | 25.6.2009 | - | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) – Agjencia Kadastrale e Kosovës. | Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri |
| 10 | Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit | 3.7.2009 | - | MPB, MF, AIK | Komisioni për Siguri |
| 11 | Plani Zhvillimor Strategjik 2009-2013 i Entit Statistikor të Kosovës | 10.8.2009 | - | MAP | Komisioni për Arsim |
| 12 | Strategjia e Energjisë 2009-2018 | 10.9.2009 | 1.4.2010 | Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) | Komisioni për Zhvillim Ekonomik |
| 13 | Miratohet Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Migracion dhe Plani i Veprimit | 10.9.2009 | - | MPB | Komisioni për Siguri |
| 14 | Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit dhe Plani i Veprimit 2009-2012 | 15.10.2009 | - | MPB | Komisioni për Siguri |
| 15 | Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin dhe Grumbullimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta 2010-2012 | 6.11.2009 | - | Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) | Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë (*Shkurt: Komisioni për Siguri*) |
| 16 | Strategjia e Transportit Multimodal dhe Plani i Veprimit | 13.11.2009 | - | Ministria e Infrastrukturës | Komisioni për Zhvillim Ekonomik |
| 17 | Strategjia Kosovare për Rini dhe Plani i Veprimit 2010 – 2012 | 13.11.2009 | - | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) | Komisioni për Arsim |
| 18 | Plani Strategjik i Kosovës për HIV/AIDS 2009-2013 | 4.12.2009 | - | MSH | Komisioni për Shëndetësi |
| 19 | Strategjia e punësimit 2010-2012 | 23.12.2009 | - | ZK<br>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)<br>Komiteti Ndërministror | Komisioni i Shëndetësisë |
| 20 | Plani Zhvillimor Strategjik 2009-2013 i Ministrisë së Administratës Publike | 9.1.2010 | - | MAP | Komisioni për Arsim |
| 21 | Planit Zhvillimor Strategjik 2009-2013 i | 22.1.2010 | - | MPB | Komisioni për Siguri |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Ministrisë së Punëve të Brendshme | | | | |
| 22 | Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013 | 12.2.2010 | - | MKK | Komisioni për Komunitete |
| 23 | Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020 | 12.2.2010 | - | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) | Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor (*Shkurt: Komisioni për Bujqësi*) |
| 24 | Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009-2018 | 30.3.2010 | - | MASHT, MSH, MMPH, MKRS | Komisioni për Arsim<br>Komisioni për Shëndetësi<br>Komisioni për Bujqësi |
| 25 | Plotësimi dhe Ndryshimi i Strategjisë për Riatdhesimin e Personave të Riatdhesuar, dhe<br>Plani i Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar | 26.5.2010<br>(PV është aprovuar më 28.7.2010) | - | MPB, MF | Komisioni për Siguri |
| 26 | Strategjia për Pronësi Intelektuale dhe Plani i Veprimit 2010-2014 | 11.6.2010 | - | MTI | Komisioni për Zhvillim Ekonomik |
| 27 | Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës dhe Plani i Veprimit | 15.6.2010<br>(PV është aprovuar më 20.7.2010) | - | MPB | Komisioni për Siguri |
| 28 | Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës së Metrologjisë në Kosovë 2010 – 2014 | 23.6.2010 | - | MTI | Komisioni për Zhvillim Ekonomik |
| 29 | Plani zhvillimor strategjik për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për periudhën 2009 – 2013 | 15.9.2010 | - | MAPL | Komisioni për Arsim |
| 30 | Plani Zhvillimor Strategjik për Institutin e Kosovës për Administratën Publike, për periudhën 2010 -2014 | 29.9.2010 | - | MAP | Komisioni për Arsim |
| 31 | Startegjia për Arritjen e Njohjes së Plotë Ndërkombëtare të Republikës së Kosovës | 8.6.2011 | - | MPJ | Komisioni për Punë të Jashtme |
| 32 | Startegjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020 | 29.6.2011 | - | MBPZHR | Komisioni për Bujqësi |
| 33 | Strategjia për Konservim të Integruar në Kosovë | 29.6.2011 | - | MKRS | Komisioni për Arsim |
| 34 | Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016 | 13.7.2011 | - | MPB | Komisioni për Siguri |
| 35 | Strategjia për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë 2012- | 13.7.2011 | - | MTI | Komisioni për Zhvillim Ekonomik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 34 | National Strategy and Action Plan for Community Safety 2011-2016 | 13.7.2011 | - | MIA | Committee on Security |
| 35 | Strategy for the Development of Small and Medium Enterprises in Kosovo 2012-2016 | 13.7.2011 | - | MTI | Committee for Economic Development |
| 36 | Strategy and Action Plan for Biodiversity | 20.7.2011 | 6.10.2011 | MAFRD | Committee for Agriculture |
| 37 | Strategic Development Plan of the Ministry of Environment and Spatial Planning 2011-2014 | 27.7.2011 | - | MESP | Committee for Agriculture |
| 38 | Strategic Development Plan of the Ministry for Communities and Returns 2011-2013 | 10.8.2011 | - | MCR | Committee for Communities |
| 39 | Education Strategy 2011-2016 | 25.8.2011 | - | MEST | Committee for Education |
| 40 | Kosovo Plan Against Domestic Violence and Action Plan 2011-2014 | 25.8.2011 | - | OPM | Committee on Human Rights |
| 41 | Strategy for Maternal, Child and Adolescent Health and Reproductive Health | 25.8.2011 | - | MH | Committee for Economic Development |
| 42 | National Strategy and Action Plan against Trafficking in Human Beings | 01.09.2011 | - | MIA | Committee on Security |
| 43 | Strategy for and Action Plan for Prevention and Elimination of Child Labor in Kosovo 2011-2016 | 13.10.2011 | - | MLSW | Committee on Health |
| 44 | The strategy of the Kosovo Security Force | 19.10.2011 | - | Ministry of Security Force | Committee on Security |
| 45 | Mining Strategy of the Republic of Kosovo for the period 2012 - 2025 | 16.11.2011 | - | MED | Committee for Economic Development |
| 46 | Action Plan for European Partnership 2012 | 21.12.2012 | - | Government of Kosovo | Committee for European Integration |
| 47 | Anti Corruption Strategy and Action Plan 2012-2016 | 11.1.2012 | Currently under review in Assembly | Anti-corruption Agency (ACA) | Committee for Legislation |

*Publikimi i këtij doracaku është mundësuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI).*

NDI
NATIONAL DEMOCRATIC INSTITUTE FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA